

HAXHAH LIZA ABDULLAH (ANGELA MILO)

KUR'ANI NË JETËN E PËRDITSHME

Përktheu dhe përshtati nga gjuha arabe:
Mr. Sci. Fehim Xh. Dragusha



*Kryesia e Bashkësisë Islame "El-Hidaje",
Islamischen Gemeinschaft, Herisauerstrasse 52,
Saint Gallen Zvicër
www.el-hidaje.ch*

Titulli i origjinalit anglisht:

“The Qur’an in Our Everyday Life”

Angela Milo (Hajjah Liza Abdullah) ©

4000 Shah Alam, Selangor Darul Ehsan, Malaysia 2000

Redaktor:

Edin Q. Lohja

Recenzent:

Mr. Ajni Sinani

Design & Layout:

Arsim Murseli

Për botuesin:

Xhamia “El-Hidaje”

Saint Gallen, Zvicër

Botimi i tretë

Tetor, 2009

Përkthimi i këtij libri i kushtohet shpirtit të hoxhës, atdhetarit, dëshmorit kosovar Bajrush Dragusha, i cili u largua nga familja jonë në fillim të shekullit XX.

Në shenjë respekti nga përkthyesi

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَكِّرٍ

“Ne e bëmë Kuranin të lehtë për t’u mësuar, po a ka njeri që merr mësime?” (Kamer, 17)

ABSTRACT

Good or bad? Right or wrong? Should I or shouldn't I? These questions baffle the Human Beings as he tries to live a godly life. The answers lie in the Qur'an, a Book that embraces every aspect of daily living.

It balances the spiritual and materialistic side of Mankind and shows how both entities can co-exist. How then does one live according to the teachings of the Qur'an?

Liza Abdullah searched the Scripture and has arrived at the simple steps through which one can walk closer to God. She singles out verses which relate to issues close to the heart: loyalty versus justice, family and friends, speaking out for truth, business ethics, charity and prayer, happiness and suffering, individual responsibility, and submission to God.

On a more personal level the Qur'an also has instruction on how one should dress and maintain physical hygiene.

Ultimately, the decision to live according to the teaching of the Qur'an lies with the individual. But good things come to those who choose to place their hands in God and trust His guidance. And the best thing in that God does not ask for the impossible, as this book shows.

REZYME

E mirë apo e keqe? E drejtë apo e gabuar? Ta kryej apo jo? Këto pyetje e hutojnë njeriun, në përpjekjen e tij për të çuar një jetë të përzotshme. Përgjigjet ndodhen në Kuran, librin që përfshin çdo aspekt të jetës së përditshme.

Ai barazpeshon anën shpirtërore dhe materiale të njerëzimit, duke treguar mënyrën se si ato mund të bashkekzistojnë. Si jetohet, atëherë, sipas mësimëve të Kuranit?

Liza Abdullah e hulumtoi Librin e Shenjtë, Kurantin dhe arriti tek hapat e thjeshtë që mund të na shpiejnë më pranë Zotit. Ajo ka veçuar ajete të cilat lidhen me çështje që i kemi më për zemër, si: besnikëria karshi drejtësisë, familja dhe miqtë, thënia e së vërtetës, etika e ndërveprimeve ekonomike, bamirësia dhe lutja, lumturia e vuajtja, përgjegjësia vetjake dhe nënshtrimi para Zotit.

Në një nivel edhe më personal, Kurani përmban këshilla mbi estetikën e veshjes dhe mirëmbajtjen e higjienës.

Përfundimisht, vendimi për të jetuar sipas mësimëve të Kuranit qëndron tek individi. Por mirësitë u vijnë atyre që zgjedhin t'i dorëzohen Zotit dhe t'i besojnë udhërrëfimit të Tij. E më e mira është se Zoti nuk kërkon të pamundurën, siç e tregon qartë edhe ky libër.

PËRMBLEDHJE

E mirë apo e keqe? E drejtë apo e gabuar? Ta kryej apo jo? Këto pyetje e hutojnë njeriun, kur ai përpiqet që të bëjë një jetë të mirë. Përgjigjet e tyre ndodhen në Kuran, në librin që përfshin çdo aspekt të jetës së përditshme.

Ai barazpeshon anën shpirtërore dhe materiale të njerëzimit, duke treguar mënyrën se si mund të bashkëjetojnë ato. Si jetohet, atëherë, sipas mësimeve të Kuranit?

Liza Abdullah e hulumtoi Librin e Shenjtë të muslimanëve dhe arriti tek hapat e thjeshtë që mund të na shpiejnë më pranë Zotit. Ajo ka veçuar ajete të cilat lidhen me çështje që i kemi më për zemër: besnikëria karshi drejtësisë, familja dhe miqtë, thënia e së vërtetës, etika në punë, bamirësia dhe falja, lumturia e vuajtja, përgjegjësia vetjake dhe nënshtrimi para Zotit.

Në një nivel edhe më personal, Kurani përmban këshilla mbi mënyrën e veshjes dhe mirëmbajtjen e higjienës fizike.

Përfundimisht, vendimi për të jetuar sipas mësimeve të Kuranit qëndron tek individit. Por mirësitë u vijnë atyre që zgjedhin t'i dorëzohen Zotit dhe t'i besojnë udhërrëfimit të Tij. Dhe gjëja më e mirë është se Zoti nuk kërkon të pamundurën, siç e tregon qartë edhe ky libër.

FJALA E PËRKTHYESIT

Falenderimet dhe lëvdatat e shumta i takojnë vetëm Krijuesit, Sunduesit të kësaj Gjithësie, ndërsa përshëndetjet më të sinqerta i përkasin të dërguarit të fundit, Muhammedit [alejhisselam], shokëve të tij dhe mbarë pasuesve gjer në Ditën e Llogarisë.

Libri 'Kurani në Jetën e Përditshme' është një punë mjaft e çmuar e autores Haxha Liza Abdullah, e cila gjatë punës së saj në hartimin e tij është munduar të sjellë tema të ndryshme të përditshmërisë sonë, duke i argumentuar ato me vargje kuranore. Krahas ajeteve, autorja është orvatur që temat t'i ilustrojë edhe me shembuj praktikë, që lexuesi të mund ta jetojë temën dhe ta ndiejë rëndësinë e saj në jetën tonë të përditshme. Nuk ka dyshim se libri synon përmirësimin e individit dhe shoqërisë, duke i dhuruar një imazh më të mirë nga ajo që gëzonin dikur. Ai është një punë mjaft e çmuar, e cila në çastin më të duhur sheh dritën me sy, ndërkohë që rininë islame në mbarë globin e ka kapluar injoranca dhe më tutje kjo injorancë është ujitur me vite, duke i ushqyer muslimanët me libra e lexime boshe që si burim kishin mendjen e devijuar. Si rezultat i tërë kësaj, autorja ka ardhur me një grup temash me përmbajtje mjaft të thukët, prandaj, kam bindjen se lexuesi do të ketë rastin ta lexojë brenda një kohe të shkurtër dhe ta kuptojë rëndësinë e jetës së tij si mëkëmbës i Zotit në tokë dhe si qenie me mision të posaçëm.

Vlen të përmendet se në këtë libër nuk është spikatur asnjë hadith (thënie) i Pejgamberit [alejhisselam]. Vetë fakti se autorja ka kohë që merret me punime të fushës së Tefsirit Tematik shpjegon sjelljen e argumenteve kuranore që kanë të bëjnë me temat përkatëse, pa e cekur fare shkencën e hadithit. Kam bindjen se në të ardhmen, autorja do të na lejojë t'i shtojmë çdo teme edhe nga një hadith, çka do të ishte në favor të lexuesit.

Lexuesi do të ketë rastin që gjatë leximit të këtij libri, të njihet me aspektet praktike të jetës së tij dhe mënyrën e të zbatuarit të Kuranit gjatë 24-orëshit, duke filluar nga dalja prej shtëpisë, mirësjellja, përhëndetja, përgjegjësia, mënyra e veshjes, pastërtia, të biseduarit, fjalori, morali, etika e ndërveprimeve, pasuria, premtimet, gënjeshtra, shejtani, bixhozi e pijet alkoolike, higjiena, rregullat ushqimore, namazi, lëmosha, shëndeti, familja, frika, vuajtja dhe lumturia, durimi (sabri) e më në fund vdekja. Pra, secili nga ne, herët apo vonë, do të ballafaqohet me temat e sipërsënuara, prandaj është koha për t'u parapërgatitur, në mënyrë që kur të sprovohemi me to, të jemi të gatshëm që t'i kalojmë me sukses, gjithnjë duke u mbështetur në dritën e Kuranit.

Të dashur lexues, vërtetë libri është qëndisur ashtu si duhet dhe si i tillë, do të ketë efektin e tij duke ngjallur sadopak besimin e individit dhe shoqërisë në një anë, dhe duke përmirësuar moralin dhe ndërgjegjen e tyre në anën tjetër.

Lusim Allahun e Madhërishëm, që autoren e librit dhe të gjithë ata që punuan në botimin e tij t'i shpërblejë me të mirat e kësaj bote dhe asaj që vjen. Këtu do të falënderoja zotërinjtë Ermal Bega, Ejup Ramadani,

znj. Jeta Islami dhe Rahmah Ramli Dragusha, të cilët
më përkrahën në çdo moment dhe më ndihmuan deri
në realizimin e versionit përfundimtar të librit në shqip,
për të cilën u jam mirënjohes nga zemra.

Mr. Fehim Xhafer Dragusha
Brunei Darussalam
Nëntor 2007

PARATHËNIE

Në forumin e organizuar nga Shoqata Islame isha e ftuar që të flisja mbi temën “Unë dhe Islami.” Një zotëri parashtroi pyetjen: “Si ta zbatojmë Kuranin në jetën e përditshme apo si ta jetojmë jetën tonë sipas mësimëve kuranore?” Koha për t’iu përgjigjur pyetjes së shtruar ishte shumë e shkurtër; pyetja ishte vërtet tërheqëse, ndaj s’e kisha të lehtë që t’i përgjigjesha aty për aty, për shkak të kohës shumë të shkurtër që kisha në dispozitim.

Në kohën kur prezantova temën në fjalë, zotëroja diplomën nga Universiteti Islam Ndërkombëtar i Malajzisë (IIUM) në degën e Shkencave Islame, ku edhe vazhdoja mësimdhënien, ndaj vendosa të shkruaj një punim, përmes të cilit do mund t’iu përgjigjesha më mirë pyetjes së lartpërmendur.

Ndihem shumë e gëzuar që propozimi im për të shkruar mbi këtë çështje u pranua me gatishmëri, prandaj jam orvatur që, me mundin tim, të jap përgjigje mbi mësimet kuranore.

Haxhah Liza Abdullah (Angela Milo)

Ramazan 1418/ Dhjetor 1997

Shah Alam – Malajzi

HYRJE

Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Si është e mundur që ne, si qenie njerëzore ta dallojmë të drejtën nga e padrejta? Ku është udhëzimi? Allahu, nga mëshira e Tij na dhuroi Librin e Shenjtë. Një libër shumë i veçantë, i cili u flet të gjitha qenieve njerëzore që jetojnë mbi tokë; gjuha e tij është universale sepse u drejtohet dhe u flet zemrave. Emri i tij është Kuran. Në të mbizotëron drita e udhëzimi dhe vetëm kur ta studiojmë këtë libër të shenjtë, do të vërejmë se ai dallon nga librat e tjerë. Kur e themi këtë, kemi për qëllim Kurandin, i cili përfshin shumë ngjarje nga e kaluara dhe e tashmja, duke qenë gjithashtu lajmërues dhe përgëzues për ato që do të ndodhin në të ardhmen.

Nuk ka aspak mundësi që një qenie njerëzore të sjellë një libër të tillë si Kurani, duke patur parasysh se mendja dhe logjika e kufizuar e njeriut nuk ka mundësi t'i rrokë të gjitha aspektet e jetës. Ngjarjet e cekura në Kuran lidhur me veprimet e shumta të njeriut, qofshin vepra apo fjalë, janë aq të freskëta sikur të ishin shkruar dje; gjithashtu edhe ngjarjet e vjetra të cilat duken sikur të ishin regjistruar në kohën e krijimit të Ademit [alejhissalam], tregojnë se Kurani përfshin të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Përvoja jonë nga jeta e përditshme, puna, profesioni e pozita... është e larmishme, në sajë të shumë faktoreve. Secilit njeri i janë dhënë njëzet e katër orë në ditë, prandaj çdonjëri prej nesh zotëron lirinë e zgjedhjes: të veprojë mirë apo keq, pa marrë parasysh gjendjen në të cilën ndodhemi.

Në mënyrë që t'i zbatojmë mësimet kuranore në jetën e përditshme, nevojitet që në fillim të kuptohen disa gjëra tepër të rëndësishme për të gjithë ne: kur e ka zanafillën krijimi ynë? Ne, në të njëjtën kohë, ishim të krijuar në formë shpirtërore. Më pas, të gjithëve na u kërkua që të dëshmojmë dhe ashtu vepruam; ja pra, kjo që edhe marrëveshja jonë:

وَهُوَ الَّذِي أَنشَأَكُم مِّن نَّفْسٍ وَاحِدَةٍ فَمُسْتَقَرٌّ وَمُسْتَوْدَعٌ قَدْ

فَصَلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَفْقَهُونَ ﴿٩٨﴾

“Është Ai që ju krijoi (filloi) prej një njeriu; aty (mbi tokë) jetoni (qëndroni) dhe në të do të pushoni. Ne ia sqaruam argumentet një populli që di të kuptojë.”¹

وَإِذْ أَخَذَ رَبُّكَ مِن بَنِي آدَمَ مِنْ ظُهُورِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَأَشْهَدَهُمْ عَلَى

أَنفُسِهِمْ أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ قَالُوا بَلَىٰ شَهِدْنَا أَن نَقُولُوا يَوْمَ

الْقِيَامَةِ إِنَّا كُنَّا عَنْ هَذَا غَافِلِينَ ﴿٩٩﴾

“Përkujto kur Zoti yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tij dhe i bëri dëshmuar të vetes së tyre (duke u thënë): ‘A nuk jam Zoti juaj?’ Ata u përgji-

¹ El-En’am (6), ajeti 98.

gjën: 'Po, dëshmuam!' Të mos thoni në ditën e kija-
metit: 'Ne për këtë (dëshmim) nuk ishim në dijeni'."²

Qëllimi ynë në këtë botë është që të përmbushim marrëveshjet. Pikërisht për këtë, shohim njerëz duke shikuar dhe hulumtuar gjëra të reja, duke vënë veten e tyre në telashe, asnjëherë të kënaqur me çfarë zotërojnë. Arsyeja e tërë kësaj është se ata, ne dhe mbarë njerëzimi mendojmë se gjërat materiale të kësaj bote do të na bëjnë më të lumtur. Me të arritur diçka të re, pra pas blerjes së saj, lumturia zgjat vetëm disa çaste, e pastaj orvatemi sërish që të blejmë diçka tjetër, më të madhe, më të mirë, më të bukur e kështu me radhë. Kërkimi ynë sosit në çastin kur vërejmë se ajo që kërkojmë gjendet brenda nesh, ajo pra qenka marrëveshja jonë e lash-të dhe e vjetër; të jemi të vetëdijshëm se Allahu ekziston dhe se vetëm Ai meriton të adhurohet e të falënderohet!

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ
أَسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ ۗ مَا لَكُمْ مِّن دُونِهِ مِن وَّلِيٍّ وَلَا شَفِيعٍ ۗ أَفَلَا
تَتَذَكَّرُونَ ﴿١﴾

“Allahu është Ai që krijoi qiejt e tokën dhe gjithçka ndërmjet tyre, brenda gjashtë ditësh, pastaj mbizotëroi Arshin. Përveç Tij nuk keni ndihmëtar e as ndërmjettësues tjetër, pra, a s’po mendoni?”³

² El-A’rafë (7), ajeti 172.

³ Es-Sexhde (32), ajeti 4.

الَّذِي أَحْسَنَ كُلَّ شَيْءٍ خَلَقَهُ^ط وَبَدَأَ خَلْقَ الْإِنْسَانِ مِنْ طِينٍ ﴿٧﴾
 ثُمَّ جَعَلَ نَسْلَهُ مِنْ سُلَالَةٍ مِّنْ مَّاءٍ مَّهِينٍ ﴿٨﴾ ثُمَّ سَوَّاهُ وَنَفَخَ فِيهِ
 مِنْ رُّوحِهِ^ط وَجَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَالْأَفْئِدَةَ قَلِيلًا مَّا
 تَشْكُرُونَ ﴿٩﴾

“Është Ai që përsosi krijimin e çdo sendi dhe krijimin e njeriut e filloi nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët. Mandej, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) dhe nga ana e vet i jep shpirt; dhe Ai është që ju pajis edhe me dëgjim, me shikim dhe me zemër, dhe fare i vogël është falënderimi juaj.”⁴

Në të vërtetë, nga kjo dituri themelore e ofruar nga vargjet kuranore, arrijmë të kuptojmë se jemi të krijuar nga dy përbërës kryesorë: ana shpirtërore (shpirti) dhe materiale (trupi). Në momentin kur na ka zbritur Kurani, na është dhuruar gjithashtu edhe ekuilibri, përmes të cilit këto dy përbërje do të bashkëjetojnë paralelisht, në paqe dhe harmoni; si rrjedhojë, jeta e njeriut do të marrë drejtim edhe më të bukur. Si mund të arrijmë një jetë krejtësisht të barazpeshuar e të përsosur? A është kjo një ëndërr e porealizueshme apo fantazi (utopi)? Jo, kjo vërtetë përbën një realitet.

⁴ Es-Sexhde (32), ajeti 7-9.

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ وَنَعْلَمُ مَا تُوَسَّوَسُ بِهِ نَفْسُهُ ۖ وَحَنُّ أَقْرَبُ

إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ ﴿١٦﴾

“Ne e kemi krijuar njeriun dhe e dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër atij sesa damari i qafës.”⁵

Trupi dhe shpirti, ku me shpirt nënkuptojmë egon që urdhëron dhe nxit në vepra të këqija, ndërsa trupi vepron sipas tyre:

وَمَا أُبْرِئُ نَفْسِي ۚ إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي ۚ إِنَّ

رَبِّي غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٥٣﴾

“Unë nuk e shfajësoj veten time, sepse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç për atë që e ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im falë e mëshiron shumë.”⁶

Është vërtetuar se egoja është në gjendje ta nxisë njeriun në gjynahe dhe vepra të shëmtuara të djallit, me të cilën ai dëshiron të na nxisë që të ketë një zgjedhje. Zgjedhja daton qysh nga fillimi i krijimit të njeriut: mirë apo keq? Të veprojmë apo jo? Të flasim apo të heshitim? Emocionet, ndjenjat, shqetësimet, dashuria, egoja, arroganca, urrejtja – të gjitha këto cilësi luajnë rol drejt zgjedhjeve tona. Le të mësojmë se si ta zbatojmë Ku-

⁵ Kaf (50), ajeti 16.

⁶ Jusuf (12), ajeti 53.

ranin në jetën tonë, apo - thënë më mirë - si ta jetojmë Kuranin në jetën e përditshme. Pas gjithë kësaj, duhet ta dimë se çdo ditë përmbledh jetën tonë.

1. Zbatimi i Kuranit jashtë shtëpisë

I. ZBATIMI I KURANIT JASHTË SHTËPISË

Po nisim me mëngjesin. Me dalje nga shtëpia nënkuptojmë kryerjen e punëve, pazarit apo obligimeve të tjera të jetës së përditshme. Shembulli më i bukur që do ta ilustronte këtë mund të jetë tregimi i As'hab el-Kehf (Banorët e Shpellës)⁷, të cilët i besuan Allahut dhe nga frika e mosbesimit u larguan nga vendlindja, duke e lutur Zotin e Madhërishëm për ndihmë, siç tregohet edhe në Kuranin Famëlartë:

إِذْ أَوْىءَ الْفِتْيَةُ إِلَى الْكَهْفِ فَقَالُوا رَبَّنَا آتِنَا مِن لَّدُنكَ رَحْمَةً

وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا ﴿١٠﴾

“Kur djelmohat u strehuan në shpellë, thanë: ‘O Zoti ynë, na dhuro mëshirë nga ana Jote dhe na përgatit udhëzim të drejtë në gjithë çështjen tonë!’”⁸

⁷ Banorët e Shpellës apo As'habul Kehf ishin disa djelmohat të rinj, me besim të fortë në Zotin Fuqplotë. Ata u larguan nga vendlindja vetëm për të ruajtur besimin dhe u strehuan në një shpellë (ar. *kehf*). Qëndrimi i tyre në të kaloi në gjumë dhe periudha kohore e qëndrimit të tyre në shpellë, siç e përmend edhe vargu kur'anor, ishte treqind e nëntë vjet. (*shën. i përk.*)

⁸ El-Kehf (18), ajeti 10.

Këto fjalë janë shumë të thjeshta për t'u kuptuar; ato na dhurojnë mbështetje te Krijuesi i Gjithësisë. Banorët e shpellës qëndruan në gjumë të thellë afro 300 vjet; iknin me vrap nga njerëzit të cilët Allahut i kishin bërë shok. Kërkuan nga i madhi Zot që t'i mëshironte e t'i udhëzonte në rrugën e drejtë, t'u rregullonte çështjet e tyre që kishin të bënin me besimin e pastër.

Sot, në ditët tona, jemi të lirë të besojmë në Allahun e Plotfuqishëm, së këndejmi nuk kemi as problemet me të cilat u ballafaquan banorët e shpellës, *as'hab el-kehf*.

Megjithatë, sapo dalim nga shtëpia takojmë njerëz të ndryshëm, e pikërisht për këtë jemi të detyruar që nga Sunduesi i kësaj Gjithësie të kërkojmë ndihmë, udhëzim e mëshirë, më shumë se kurrë më parë. Çdo mëngjes, para se të dal nga shtëpia, lexoj ajetin e lartpërmendur.

2. Përshëndetja

II. PËRSHËNDETJA

Edhe përshëndetja në këtë rast ka të bëjë me zbatimin e mësimëve kuranore në jetën tonë të përditshme, kështu që kur të takojmë dikë, e kemi për detyrë që ta përshëndesim në mënyrën më të mirë.

Allahu i Gjithmëshirshëm në Librin e Tij Famëlartë thotë:

وَإِذَا حُيِّتُمْ بِتَحِيَّةٍ فَحَيُّوا بِأَحْسَنَ مِنْهَا أَوْ رُدُّوهَا إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا

كُلِّ شَيْءٍ حَسِيبًا ﴿٨٦﴾

*“Kur përshëndeteni me ndonjë përshëndetje, kthejeni përshëndetjen edhe më të mirë, ose po ashtu. Allahu llogarit për çdo gjë.”*⁹

Ky ajet kuranor na bën të kuptojmë se Allahu xh.sh. llogarit për çdo gjë, pra edhe përshëndetja merret në shqyrtim. Ka të ngjarë që shumë jomuslimanë i përshëndesin muslimanët me përshëndetjen islame *Esselamu Alejkum* (Paqa e Allahut qoftë mbi ju) dhe më bën të mërzitem pa masë kur shoh muslimanët duke mos e kthyer përshëndetjen.

Kur pata rastin t'i pyes për shkakun e sjelljes së tyre në lidhje me këtë problematikë, m'u përgjigjën duke

⁹ En-Nisa (4), ajeti 86.

thënë: “Kemi frikë se ata janë duke u tallur me ne.” Për ne nuk është me rëndësi që të merremi me atë se a janë duke u tallur apo janë të sinqertë në dhënien e selamit! Në fakt, ne s’mund të themi se kjo është e vërtetë, për arsye se nuk posedojmë mundësinë e të lexuarit të qëllimeve të tyre; nuk jemi përgjegjës e as nuk kemi kompetencë mbi këtë çështje, ne kemi përgjegjësi për veprat dhe për punët tona, pra kudoqoftë dhe sa herë që dikush na përshëndet, jemi të obliguar t’ia kthejmë selamin, kjo sipas ajetit të lartpërmendur, i cili na mëson që nëse nuk e kthejmë përshëndetjen më të mirë, atëherë t’u kthejmë një përshëndetje të ngjashme me të tyren.

3. Të shogëruarit

III. TË SHOQËRUARIT

Duke lundruar me anijen e Kuranit, arrijmë te porti i shoqërimit dhe ja, duke vizituar të afërmit, miqtë, shoqët dhe pa i hedhur vështrim vizitave të shpeshta dhe në kohë të ndryshme, shohim se nuk jemi në gjendje të vërejmë sjelljet tona aq të këqija. Për këtë, Allahu i Plotfuqishëm na mëson:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّىٰ
تَسْتَأْذِنُوا وَتُسَلِّمُوا عَلَىٰ أَهْلِهَا ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ لَعَلَّكُمْ
تَذَكَّرُونَ ﴿٢٨﴾ فَإِن لَّمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا فَلَا تَدْخُلُوهَا حَتَّىٰ
يُؤْذَنَ لَكُمْ وَإِن قِيلَ لَكُمْ ارْجِعُوا فَارْجِعُوا هُوَ أَزْكَىٰ لَكُمْ
وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴿٢٩﴾ لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَن تَدْخُلُوا
بُيُوتًا غَيْرَ مَسْكُونَةٍ فِيهَا مَتَاعٌ لَّكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ وَمَا
تَكْتُمُونَ ﴿٣٠﴾

“O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e tyre. Kjo është më mirë për ju, që të merrni mësim. Po nëse nuk gjeni asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’ju jepet leje, e nëse ju thuhet që të ktheheni, ju kthehuni. Kjo është

më e ndershme për ju. Allahu e di çdo gjë që veproni. Nuk është për ju ndonjë gjynah, nëse hyni në shtëpi të pabanuara, në të cilat keni ndonjë përfitim. Allahu e di atë që e shfaqni haptas dhe çfarë e mbani të fshehtë.”¹⁰

Nga ky ajet mësojmë se gjithsesi jemi të obliguar të kërkojmë leje për të vizituar shtëpinë e dikujt dhe nuk duhet të hyjmë aty, vetëm nëse na lejohet një gjë e tillë. Me këtë tregohet respekti ndaj çështjeve private të tjerëve.

Kam bindjen se gjithmonë para se të vizitojmë ndonjë të afërm apo këdo qoftë, mund t’u bëjmë një telefonatë e t’i informojmë për vizitën tonë dhe me këtë mund të shohim nëse janë të zënë apo të lirë për të na pritur. Në këtë mënyrë, mund të mënjanojmë sjelljet e këqija, që mos t’i marrim njerëzit për së lehti. Sa më shumë që t’i njohim njerëzit, aq më shumë duhet të shtohet respekti ynë ndaj tyre, e nëse nuk na lejohet që të hyjmë në shtëpitë e tyre dhe urdhërohemi për t’u kthyer, atëherë duhet të kthehemi.

¹⁰ En-Nur (24), ajetet 27 – 29.

4. Besnikëria dhe Drejtësia

IV. BESNIKËRIA DHE DREJTËSIA

Shpesh dëgjojmë njerëzit duke folur në favor të atij që e duan, edhe pse për personin në fjalë e dimë mirë se ka kryer vepra të këqija. Kjo quhet besnikëri. Kur bëjmë vepra të pahijshme, mendojmë se ai që e duam duhet të qëndrojë në krahun tonë, duke iu referuar kësaj si ‘besnikëri’. Megjithatë, me këtë gjest e kemi shumë gabim. E vërteta është elementi më i rëndësishëm drejt qeverisjes së jetës sonë; nëse jemi në gjendje t’i qëndrojmë përballë drejtësisë, atëherë me këtë automatikisht kemi arritur që të jemi të fortë në të gjitha aspektet e jetës, njëkohësisht duhet shtuar se njerëzit që kryejnë gjëra të pahijshme dënohen sipas veprës së kryer. Allahu i Madhërishtëm në lidhje me këtë thotë:

يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ بِالْقِسْطِ شُهَدَاءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَىٰ
أَنفُسِكُمْ أَوِ الْوَالِدِينَ وَالْأَقْرَبِينَ ۚ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا فَاللَّهُ
أَوْلَىٰ بِهِمَا ۖ فَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَىٰ ۖ أَن تَعْدِلُوا ۚ وَإِن تَلَوُّا أَوْ تُعْرَضُوا
فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١٢٤﴾

“O ju që besuat, vazhdimisht bëhuni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër vetes suaj, kundër prindërve ose të afërmeve, qoftë pasanik ose

varfanjak, pse Allahu e di më mirë për ta. Atëherë, mos e ndiqni emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu e di hollësisht se çfarë punoni.”¹¹

Kur të mbrojmë ndonjë person nga ndëshkimi mbi veprën dhe gabimin e bërë, ka të ngjarë që mos ta dallojmë, mirëpo në këtë rast kemi bërë dy gabime;

Së pari: Nuk jemi përkrahës të së mirës,

Së dyti: Inkurajojmë keqbërësin që të bëjë vepra të këqija edhe më tej. Personi i cili është sjellë në mënyrë të padenjë mësohet që t'i shmanget dënimit, së këndejmi, ai vazhdon jetën e tij të mëparshme duke bërë gjynahe.

Natyrisht, kur kemi të bëjmë me njerëz të dashur, që janë përfshirë në vepra të këqija, është e vështirë që të dëshmohet sipas drejtësisë, mirëpo, në të njëjtën kohë, është shumë e lehtë që të ngrihemi dhe të jemi përkrahës të drejtësisë, t'i shmangemi së ligës dhe keqbërësve. Ç'është vepruar më tutje? Këtu kemi përgjigjen:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا
يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰ ءَلَّا تَعْدِلُوا ؕ أَعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ
لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٣٥﴾

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni

¹¹ En-Nisa (4), ajeti 135.

drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më pranë devotshmërisë. Kijeni frikë Allahun, sepse Allahu di për çdo gjë që veproni.”¹²

Asnjëherë nuk duhet harruar të dëshmohet e drejta, pavarësisht nëse keqbërësit kanë qenë të afërm apo të largët. Në mendjet dhe zemrat tona duhet që gjithmonë të jetë parësore e vërteta dhe drejtësia. Kjo është e vetmja rrugë për të qenë të devotshëm.

¹² El-Maideh (5), ajeti 8.

5. Miqësia

V. MIQËSIA

Në Itali kemi një thënie shumë të vjetër: “Më thuaj me kë rri, që të të them se kush je.”¹³

Në këtë thënie ka shumë urtësi. Shokët që zgjedhim në jetë, të tjerëve ua bëjnë me dije se ç’njerëz jemi. Ne dëgjojmë se filani ka qenë njeri shumë i mirë, mirëpo më vonë ka rënë në shoqëri të keqe. Sidoqoftë, e vërteta është se askush nuk na drejtohet me pistoletë që të na detyrojë ta kalojmë kohën me njerëz të këqij. Ne jemi ata që e zgjedhim këtë lloj shoqërie. Më poshtë kemi këshillën kur'anore, ku Allahu i Madhërisëm thotë:

وَأَصْبِرْ نَفْسَكَ مَعَ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْغَدَاةِ وَالْعَشِيِّ
يُرِيدُونَ وَجْهَهُ ۗ وَلَا تَعْدُ عَيْنَاكَ عَنْهُمْ تُرِيدُ زِينَةَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ
وَلَا تُطِعْ مَنْ أَغْفَلْنَا قَلْبَهُ عَن ذِكْرِنَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ وَكَانَ أَمْرُهُ

فُرطًا

¹³ Autorja e këtij libri është nga Italia. Edhe në gjuhën dhe traditën shqiptare kemi shembuj të shumtë, të ngjashëm me këtë që përmend autorja. Pra, kur dikush nga ne shoqërohet me njerëz të mirë, pa dyshim se ajo i sjell dobi dhe të mira individit, familjes, shoqërisë e më tutje, mirëpo si qëndron puna me personin i cili për shoqëri të tij ka zgjedhur njerëzit e humbur, që kanë humbur veten e do të humbin edhe ata të cilët iu bashkangjiten. (shën. përk.)

“Përkufizoje veten me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes dhe mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij; dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukuritë e kësaj bote, dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën prej përkujtimit Tonë dhe i cili i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar.”¹⁴

وَيَوْمَ يَعِضُ الظَّالِمُ عَلَى يَدَيْهِ يَقُولُ يَلِيَّتَنِي أَخَذْتُ مَعَ الرَّسُولِ
 سَبِيلًا ﴿٢٥﴾ يَتَوَلَّى لِيَّتِي لَمْ أَخَذْ فُلَانًا خَلِيلًا ﴿٢٦﴾ لَقَدْ أَضَلَّنِي
 عَنِ الذِّكْرِ بَعْدَ إِذْ جَاءَنِي ۗ وَكَانَ الشَّيْطَانُ لِلْإِنْسَانِ
 خَذُولًا ﴿٢٧﴾

“Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: ‘I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit! O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, dhe djalli është ai që e humb njeriun dhe e lë të vetmuar.’”¹⁵

Të gjithë ne takojmë njerëz, të cilët na gjykojnë duke u bazuar në veturat që ngasim, rrobat që veshim etj. E tërë kjo ndodh se ky lloj i njerëzve shikojnë në vezullimin e kësaj bote dhe në anën e jashtme. Si rrjedhim, jemi të porositur që të mos shoqërohemi me këtë grup njerëzish.

Nëse dëshirojmë të qëndrojmë me ta dhe të kërkojmë atë që ata kërkojnë, atëherë shumë shpejt impono-

¹⁴ El-Kehf (18), ajeti 28.

¹⁵ El-Furkan (25), ajeti 27-29.

hemi që të bëjmë shoqëri me ta dhe të ndjekim mënyrën e jetesës së tyre. Si rezultat i tërë kësaj, ne do të bëhemi robër të epsheve tona dhe definitivisht një gjë e tillë nuk është e mirë! Le të mendojmë dhe të bëhemi sa më të kujdesshëm me shokët që zgjedhim; më në fund, ne nuk dëshirojmë të jemi nga mesi i atyre të cilët porositë e Allahut xh.sh. i kanë lënë anash e që të kërkojmë falje për gabimet që kemi bërë, pra mos të humbim kohë se më në fund do të bëhet shumë vonë. Njeriu ka vetëm një jetë për të punuar dhe vepruar. Në anën tjetër, sa më shumë që t'i kushtojmë rëndësi zgjedhjes së shokëve, aq më shumë duhet t'i rrisim raportet dhe miqësinë tonë.

Tash do të sjellim edhe një thënie të urtë italiane: “Kush ka gjetur një mik, ka gjetur një thesar.” Si rezultat i gjithë kësaj, ne duhet që gjithmonë të sillemi mirë me secilin; Kurani na mëson mënyrën se si të shoqërohemi, duke na porositur:

وَلَا تَسْتَوِ الْحَسَنَةُ وَلَا السَّيِّئَةُ ادْفَعْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا

الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ حَمِيمٌ ﴿١٦﴾

“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja, ndaj ktheje (të keqen) në mënyrën më të mirë. Se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do t’ju bëhet mik i afërt.”¹⁶

Mund të ndodhë që këto fjalë të duken si të pakuptimta, por kur ato janë të zbatueshme, marrin një kuptim dhe një perspektivë të re. Mënyra më e mirë dhe

¹⁶ Fussilet (41), ajeti 34.

më e efektshme për ta kthyer të keqen, shpaloset kur e kthejmë me të mirë, pra nëse dikush na bën keq, duhet që t'ia kthejmë me të mirë.

Të gjithë kemi nga një zemër. Sa njerëz janë të këqinj që t'i refuzojnë të mirat? Shumë pak. Në momentin kur do të zbatojmë këtë porosi dhe këshillë të bukur kuranore, jeta jonë do të pasurohet edhe më shumë.

6. Rregullat mbi veshjen islame

VI. RREGULLAT MBI VESHJEN ISLAME

Tre faktorë kryesorë luajnë rol shumë të rëndësishëm në imponimin e rrobave që veshim. Këta janë: moti, kultura dhe moda. Ndërrimi i rrobave bëhet në raport me ndërrimin e kohës gjatë vitit. Në disa vende ku temperaturat janë të buta, vërejmë se kultura luan rol të rëndësishëm, kurse në disa të tjera, moda më e fundit është e çmendur dhe pasohet në mënyrë të shfrenuar pavarërisht nga fakti nëse dukemi mirë apo jo.

Disa njerëz i kushtojnë rëndësi shumë të madhe veshjes, deri në atë shkallë sa që për këtë ekziston një thënie e vjetër: “Toga nuk të bën prift.” Kjo vlen që ne të marrim mësim dhe në të njëjtën kohë na e tërheq vërejtjen që të mos t’i gjykojmë njerëzit nga pamja e jashtme apo veshja. Ndoshta lexuesi do të pyesë për ndonjë rregull të veshjes sipas bazave të shëndosha të Kuranit?

Allahu i Madhërishëm thotë:

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَغْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا
يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ خُمُرَهُنَّ عَلَى
جُيُوبِهِنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ

ءَابَاءَ بُعُولَتِهِمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَمَلَةً
 أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِمْ أَوْ بَنِي أَخْوَاتِهِمْ أَوْ نِسَائِهِمْ أَوْ مَا مَلَكَتْ
 أَيْمَانُهُمْ أَوْ التَّبَعِينَ غَيْرِ أُولَى الْإِرْبَةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوِ الطِّفْلِ
 الَّذِينَ لَمْ يَظْهَرُوا عَلَى عَوْرَاتِ النِّسَاءِ وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ
 لِيُعْلَمَ مَا تَحْفَتْنَ مِنْ زِينَتِهِنَّ وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَ

الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تَفْلِحُونَ ﴿٣١﴾

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç bashkëshortëve, baballarëve ose baballarëve të burrave të vet, bijve të vet ose bijve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose bijve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që s’kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”¹⁷

Edhe në ajetin vijues Allahu xh.sh. thotë:

¹⁷ En-Nur (24), ajeti 31.

يَتَأْتِيهَا النَّبِيُّ قُلًّا لِّأَزْوَاجِكَ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ
 عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلْبِيبِهِنَّ ذَٰلِكَ أَدْنَىٰ أَنْ يُعْرَفْنَ فَلَا يُؤْذِينَ ۗ وَكَانَ
 اللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿٥٩﴾

“O ti Pejgamber, thuaju grave tuaja, bijave tuaja dhe grave të besimtarëve le të vënë shamitë e veta mbi trupin e tyre, sepse kjo është më e afërt që të njihen (që nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues.”¹⁸

Kërkohet nga ne (femrat) që të dalim nga shtëpia, t'i mbulojmë kraharorët me shami (mantel i cili e mbulon trupin në tërësi apo një mbulesë e cila mund të mbulojë kokën, qafën dhe kraharorin). Kur të flasim për zbatimin e Kuranit në kohën që po jetojmë, atëherë si qëndrojmë ne? Ne duhet të veshim rroba të gjera (jo të ngushta), në mënyrë që mos të ekspozojmë trupat tanë.

Doemos duhet ta kemi parasysh se kur të dalim në qytet, me vete të bartim përgjegjësinë e fesë, vendit dhe racës sonë, pavarësisht nëse jemi të ndërgjegjshëm për këtë gjë apo jo. Në shikim të parë, njerëzit do të na gjykojnë sipas asaj që veshim, dhe më vonë sipas sjelljeve dhe veprimeve tona. Allahu i Plotfuqishëm në Kuranin e Tij Famëlartë thotë:

¹⁸ El-Ahzab (33), ajeti 59.

يَبْنِي ۚ آدَمَ قَدْ أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ لِبَاسًا يُؤَارِي سَوْءَاتِكُمْ وَرِيشًا ط
وَلِبَاسُ التَّقْوَىٰ ذَٰلِكَ خَيْرٌ ذَٰلِكَ مِّنْ آيَاتِ اللَّهِ لَعَلَّهُمْ

يَذَكَّرُونَ ﴿٢٦﴾

“O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendet e turpshme dhe petk zbukurues. Por, petku i devotshmërisë, është më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut, ashtu që ata të përkujtojnë”¹⁹

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të vishemi me rrobat dhe petkun e devotshmërisë. Ne si muslimanë, sapo dalim përjashta bartim edhe flamurin e Islamit, dhe si rrjedhim duhet të jemi patjetër të depotshëm gjatë tërë kohës, që kur të na shohin të tjerët, të dëshirojnë që të bëhen si ne dhe të pasojnë veprat e moralin tonë. Çfarë kuptojmë me nocionin mirësi?

¹⁹ El-A'raf (7), ajeti 26.

7. Mirësia

VII. MIRËSIA

Allahu i Plotfuqishëm, në Kuranin e Tij Famëlartë thotë:

لَيْسَ الْبِرَّ أَنْ تُولُوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ
مَنْ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَآلَمَاتِكُمْ وَآلِكُنْبِ وَالنَّبِيِّينَ
وَأَتَى الْمَالَ عَلَى حُبِّهِ ذَوِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ
وَأَبْنِ السَّبِيلِ وَالسَّائِلِينَ وَفِي الرِّقَابِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَءَاتَى
الزَّكَاةَ وَالْمُؤْفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَاهَدُوا وَالصَّابِرِينَ فِي
الْبَأْسَاءِ وَالضَّرَّاءِ وَحِينَ الْبَأْسِ أُولَئِكَ الَّذِينَ صَدَقُوا وَأُولَئِكَ
هُمُ الْمُتَّقُونَ ﴿١٧٧﴾

“Nuk është mirësi tek të kthyerit e fytyrave tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, Ditës së Gjykimit, Engjëjve, Librave, Pejgamberëve, dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, jetimëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve si dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të dureshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës.

Të tillët janë ata të singertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.”²⁰

Kjo është veshja më e bukur që duhet të veshim ne muslimanët.

Fjala ‘Mirësi’ është e sqaruar sipas perceptimit të Allahut mbi atë që është e drejtë dhe e vërtetë, si rrjedhim edhe formula dhe sqarimi i saj është i plotë siç vijon:

Të besojmë në Allahun e Gjithmëshirshëm. Ky është vetëm fillimi i besimit, fillimi i jetës. Ata që s’i shohin shenjat dhe mrekullitë e Zotit dhe nuk besojnë në Të janë persona të verbër në zemër dhe shpirt.

Besimi në Ditën e Fundit. Të besuarit në ditën e llogarisë bën që të mos e kalojmë këtë jetë duke u kapur pas ekzistencës së botës, pasi ajo në tërësi është materiale dhe e përkohshme.

Të besuarit në engjëjt. Besimi në ekzistimin e melaikeve (engjëjve) na bën të vetëdijshëm mbi botën e padukshme, e cila është e vërtetë ashtu si gjithçka që shohim përreth nesh.

Besimi në Librat e Allahut. Prej këtyre, Kurani është një udhëzim hyjnor si dhe një dhuratë nga Allahu i Madhërishtëm.

Të besuarit në të dërguarit e Allahut. Çdo peygamber ka sjellë ndryshime të cilat në tërësi ishin për të mirën e njerëzimit.

Të shpenzojmë nga pasuria që zotërojmë si për prindërit, të afërmit, jetimët, skamnorët, udhëtarët e nevojtarët. Thënë shkurt, duhet që të kujdesemi për çdokënd

²⁰ El-Bekare (2), ajeti 177.

që ka nevojë për ndihmë. Shoqëria e plotë dhe e mrekullueshme është ajo e cila për hir të Allahut zgjeron kufijtë e saj duke u ndihmuar të tjerëve.

Të falurit. Allahu i Madhërishëm është gjithherë me ne dhe megjithatë ka porositur që të falemi vetëm pesë herë në ditë. Duke qenë të përhershëm e konstant në namaz, na bën që ta përkujtomë Krijuesin tonë përherë.

Ta japim zekatin; përdorimi i fjalës zekat së bashku me një numër të madh kuptimesh, të nxjerra nga rrënja e foljes *zeka'*, që do të thotë 'të pastrosh', pra kur ta nxjerrim zekatin nga pasuria jonë, ne kemi bërë pastrimin e pasurisë me dhënien e një shume të vogël. Termi zekat do të thotë virtyt, kjo në kuptimin e përgjithshëm. Së këndejmi, ne duhet të japim lëmoshë kur të shohim njerëz nevojtarë, ndërsa zekati është pjesë e të ardhurave tona, si një detyrë e drejtë. Me këtë detyrë dhe obligim fetar, ne pastrojmë veten, e një pjesë të të ardhurave tona ua kemi borxh të skamurve.

Të zbatojmë premtimet. Sa herë që japim ndonjë premtim, i vogël apo i madh qoftë, duhet ta përmbishim. Kur të veprojmë në këtë mënyrë, njerëzit do të na besojnë dhe do të kenë të ngulitur se kur të themi diçka, jemi serioz dhe një gjë e tillë do të realizohet.

Të jemi durimtarë; kjo futet ndër gjërat që më e lehtë është të thuhet sesa të praktikohen. Mjerisht, si pasojë e mungesës së kësaj cilësie, shohim se shumë gjëra të këqija ndodhin në këtë glob.

Siç e vërejmë, të veshurit me petkun e devotshmërisë përfshin edhe veprat të cilat burojnë nga vetëtitësimi mbi ekzistimin e Allahut dhe të qenurit e Tij Krijuesi. Duke veshur rroba të tilla, secili do të na

respektojë dhe do të shprehë dëshirën që të bëhet si ne.
Ashtu si bimët që tërhiqen nga drita, edhe qeniet
njerëzore i tërheq ajo që është e mirë dhe e dobishme.

8. Etika e ndërveprimeve

VIII. ETIKA E NDËRVEPRIMEVE

Për të drejtuar një biznes nevojiten shumë faktorë, si: marketingu, mbajtja e llogarive, personeli, mendjemprehtësia e profesionit dhe shumë e shumë faktorë të tjerë. Mirëpo, fillimisht zgjedhja e biznesit, cilido qoftë ai, duhet të jetë e drejtë dhe në përputhje me mësimet dhe parimet islame.

Biznesi që ka të bëjë me kumar (bixhoz/lojëra fati) është kategorikisht kundër vlerave islame, ashtu siç e dimë mirë se bixhozi dhe llojet e tij janë shpikje dhe trillime të djallit. Veç kësaj, njerëzit që punojnë me fajde (kamatë) janë të ngjashëm me ata që janë të prekur nga shejtani. Pra, edhe nëse zgjedhim çfarëdolloj biznesi, duhet të kemi parasysh se doemos duhet të hyjmë në fusha e lëmi që u sjellin dobi njerëzve dhe të mos i lëndojmë ata. Paraja duhet të fitohet në mënyrë të pastër, duke mos e toleruar në asnjë mënyrë përfshirjen tonë në korrupsion, i çfarëdo lloji qoftë ai.

I Lavdishmi në ajetin vijues thotë:

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي
يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ مِنَ الْمَسِّ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا إِنَّمَا الْبَيْعُ مِثْلُ
الرِّبَا ۗ وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ۚ فَمَنْ جَاءَهُ مَوْعِظَةٌ مِّن

رَبِّهِ فَانْتَهَىٰ فَلَهُ مَا سَلَفَ وَأَمْرُهُ إِلَى اللَّهِ وَمَنْ عَادَ فَأُولَٰئِكَ
 أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٢٧٥﴾

“Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe veçse si i çmenduri nga të prekurit e djallit. Kjo sepse thanë: ‘Edhe shitblerja nuk është gjë tjetër, por njësoj si kamata!’ E Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën. Atij që i ka arritur këshillë (udhëzim) prej Zotit të tij dhe është ndalë (prej kamatës), atij i ka takuar e kaluara dhe çështja e saj mbetet te Allahu; e kush e përsërit (pas ndalimit), ata janë banues të zjarrit, ku do të mbesin përgjithmonë.”²¹

Po ashtu, në ajetin e mëposhtëm, Allahu xh.sh. thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُم مِّنْ أَمْوَالِكُمْ أَعْصَفًا لِّمُضَعَفَةٍ
 وَأَتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١٣٠﴾

“O ju që besuat, mos e hani kamatën që po e shumëfishoni dhe kini frikë (dënimin e) Allahut, që të gjeni shpëtim.”²²

Do të flas shkurtimisht mbi kamatën, apo siç e quajmë ne “paranë me fajde.” Sot kemi shumë mendime mbi këtë temë dhe kam bindjen se një mendim më shumë nuk do të lëndoje askënd. Mendimi im është shumë i thjeshtë. Fjala kamatë apo fajde do të thotë

²¹ El-Bekare (2), ajeti 275.

²² Ali-Imran (3), ajeti 130.

interes, shtim, rritje. Disa thonë se kamata është interes vetëm atëherë kur të kalojë shumën e legalizuar, pra, nëse interesi qenka i madh, atëherë na qenka kamatë ose fajde.

Ajo që do kisha dashur të dija është: Në radhë të parë, kush e legalizoi kamatën? Pa dyshim se Zoti nuk e bëri këtë. Prandaj, pasi që tani e kemi të ditur se legalizimi i kamatës qenka bërë nga njeriu, atëherë nuk na intereson se sa është sasia e interesit, sepse faktori vep-rues këtu është njeriu. Çka ndodh me njeriun, kur përfshihet në mbledhjen e pasurisë përmes kamatës? Ai bëhet rob i parasë, sepse lakmia e nxit në veprat e tij. Është shumë e vështirë t'u ndihmojmë të tjerëve kur kemi marrë hua nga banka dhe kur të mendojmë se paratë që i kemi në bankë, përfundimisht do të na pasurojnë edhe më shumë. Mirëpo, a mund ta kalojmë jetën pa kamatë, kur të gjithë do të bëhemi të aftë për ta përdorur paranë për atë që është krijuar, si mjet; pra paraja qenka mjet, as më shumë e as më pak. Të merret kur e kërkon nevoja dhe të harrohet kur nuk kemi nevojë. Kjo është mënyra sesi ta lëvizim një tregti të mirë. Tregtia është e lejuar për ne, kurse kamata na është ndaluar. Kamata e shndërron njeriun në vegël të parasë. Si rrjedhim, mund të themi se dobitë dhe vlerat janë shumë të rëndësishme në krijimin dhe themelimin e biznesit dhe pas kësaj, ato duhen zbatuar në të gjitha fushat e menaxhimit. Sipërmarrësit mashtrues e trajtojnë stafin në mënyrë të padrejtë, tregtojnë me kamatë dhe korruptohen; të tillët janë njerëz që nuk i kuptojnë pasojat e sjelljes dhe moralit të tyre. Herët a vonë e vërteta do të dëgjohet dhe ata do ta humbin besimin e klientëve, stafit dhe partnerëve në biznes.

Allahu i Madhërishëm na porosit në Librin e Tij:

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا تَدَايَنُتُمْ بِدِينٍ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى
فَاكْتُبُوهُ ۚ وَلْيَكْتُب بَيْنَكُمْ كَاتِبٌ بِالْعَدْلِ ۚ وَلَا يَأْب كَاتِبٌ أَن
يَكْتُبَ كَمَا عَلَّمَهُ اللَّهُ ۚ فَلْيَكْتُب ۚ وَلْيَمْلِكِ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ
وَلْيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ ۚ وَلَا يَبْخَسَ مِنْهُ شَيْئًا ۚ فَإِن كَانَ الَّذِي عَلَيْهِ الْحَقُّ
سَفِيهًا أَوْ ضَعِيفًا أَوْ لَا يَسْتَطِيعُ أَن يُمِلَّ هُوَ فَلْيَمْلِكْ وَلِيَّهُ
بِالْعَدْلِ ۚ وَأَسْتَشْهِدُوا شَهِيدَيْنِ مِّن رِّجَالِكُمْ ۖ فَإِن لَّمْ يَكُونَا
رَجُلَيْنِ فَرَجُلٌ وَامْرَأَتَانِ مِمَّن تَرْضَوْنَ مِنَ الشُّهَدَاءِ أَن تَضِلَّ
إِحْدَاهُمَا فَتُذَكِّرَ إِحْدَاهُمَا الْأُخْرَىٰ ۚ وَلَا يَأْب الشُّهَدَاءُ إِذَا مَا
دُعُوا ۚ وَلَا تَسْعَمُوا أَن تَكْتُبُوهُ صَغِيرًا أَوْ كَبِيرًا إِلَىٰ أَجَلِهِ ۚ
ذَٰلِكُمْ أَقْسَطُ عِنْدَ اللَّهِ وَأَقْوَمُ لِلشَّهَادَةِ وَأَدْنَىٰ أَلَّا تَرْتَابُوا ۚ إِلَّا أَن
تَكُونَ تِجَارَةً حَاضِرَةً تُدِيرُونَهَا بَيْنَكُمْ فَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ
أَلَّا تَكْتُبُوهَا ۗ وَأَشْهِدُوا إِذَا تَبَايَعْتُمْ ۚ وَلَا يُضَارَ كَاتِبٌ وَلَا شَهِيدٌ
وَإِن تَفَعَّلُوا فإِنَّهُ فُسُوقٌ بِكُمْ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ ۗ وَاللَّهُ
بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٥٠﴾ وَإِن كُنْتُمْ عَلَىٰ سَفَرٍ وَلَمْ تَجِدُوا كَاتِبًا
فَرِهْنَنَّ مَّقْبُوضَةً ۖ فَإِن أَمِنَ بَعْضُكُم بَعْضًا فَلْيُؤَدِّ الَّذِي أُؤْتِمِنَ

أَمْنَتُهُ وَلَيَتَّقِ اللَّهَ رَبَّهُ ۗ وَلَا تَكْتُمُوا الشَّهَادَةَ ۗ وَمَنْ يَكْتُمْهَا

فَأِنَّهُ آثِمٌ قَلْبُهُ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴿٢٢٢﴾

“O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë. Dhe nga mesi juaj le të shkruajë një shkrues i drejtë e të mos ngurrojë nga të shkruarit ashtu siç e ka mësuar Allahu. Le të shkruajë, atij le t’i diktojë ai që pranon borxhin e t’i frikësohet Allahut, Zotit të tij e të mos lëre mangut asgjë nga ai. E në qoftë se ai që ngarkohet me borxh është i paafte mendërisht, është i mitur ose nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë drejt kujdestari i tij. Kërkonit të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi juaj, e në qoftë se nuk janë dy burra, atëherë një burrë e dy gra, nga dëshmitarët që i pëlqeni. (Dy gra në vend të një burri) Pasi nëse njëra prej tyre gabon, t’ia përkujtojë tjetra. Dëshmitarët të mos refuzojnë kur të thirren. Dhe mos përtoni për ta shkruar atë dhe afatin e tij, i vogël qoftë ose i madh, sepse kjo është më e drejtë tek Allahu, më e fortë për dëshmi dhe më afër mosdyshimit. Vetëm nëse është tregti e menjëhershme që ushtroni mes jush, atëherë nuk përbën ndonjë mëkat nëse nuk e shënoni. Por, kur bëni shitblerje, dëshmojeni! E ai (pronari i pasurisë) nuk dëmton as shkruesit as dëshmitarët, e nëse e bëni (dëmtimin), ai është mosrespekt i juaj (ndaj dispozitave të Allahut). Kini frikë Allahun se Allahu ju dhuron dituri, Allahu është i gjithëdijshëm për çdo gjë. Nëse gjendeni në udhëtim dhe nuk gjeni shkrues, atëherë merrni peng (paradhënie ose kapar). E nëse i besoni njëri-tjetrit, ai të cilit i është besuar le ta zbatojë atë (amanetin) që i është besuar, dhe le ta ketë frikë Allahun,

Zotin e tij. Mos e fshehni dëshminë, sepse kush e fsheh atë është gjynahqar me zemrën e vet, Allahu e di se çfarë veproni.”²³

Këtu shohim rëndësinë e të shkruarit të ndonjë kontrate gjatë marrjes së huasë apo kur të tregtojmë me njerëz si dhe nevojën e pranisë së dëshmitarëve në çastin e nënshkrimit të kontratës.

Është me rëndësi të ceket se gjatë shkrimit të kontratës duhet të kemi dy dëshmitarë; nëse atypari nuk gjenden dy burra të gatshëm, atëherë na nevojiten një burrë e dy gra. Përse obligohemi të posedojmë dy gra në vend që të kemi një burrë e një grua? Kjo bëhet për ‘ne’ gratë, për arsye se familja është shumë me rëndësi dhe si rrjedhim, mund të anojmë në anën e saj, pra në anën e familjes.

Dikur, personalisht kisha rastin të dëshmoj një shembull të ngjashëm mu në familjen time; motra ime thoshte se ajo anon nga bashkëshorti i saj, ishte një çështje private. Ky ishte rasti që më bëri të kuptoj dhe ta shoh urtësinë e Kuranit, apo thënë më mirë, ta shoh urtësinë e Allahut në vepra.

Allahu xh.sh. thotë:

يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ إِلَّا
أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً عَنْ تَرَاضٍ مِّنْكُمْ وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ إِنَّ اللَّهَ
كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا

²³ El-Bekare (2), ajetet 282-283.

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të ndaluar, përveç tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri të ndërsjelltë, dhe mos e mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm për ju.”²⁴

Po ashtu në ajetin vijues, Allahu xh.sh. thotë:

أَوْفُوا الْكَيْلَ وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُخْسِرِينَ ﴿٢٤﴾ وَزِنُوا بِالْقِسْطِ
الْمُسْتَقِيمِ ﴿٢٥﴾ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ وَلَا تَعْتُوا فِي
الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿٢٦﴾ وَاتَّقُوا الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالْجِيلَ الْأَوَّلِينَ

“Plotësojeni matjen, e mos u bëni prej atyre që lënë mangut! Dhe matni me peshore të saktë e mos i lini mangut sendet e njerëzve; e mos bëni shkatërrime në tokë. Frikësojuni Atij që ju krijoi juve dhe brezat e mëparshëm.”²⁵

وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ ﴿٢٧﴾ أَلَّا تَطْغَوْا فِي الْمِيزَانِ
﴿٢٨﴾ وَأَقِيمُوا الْوَزْنَ بِالْقِسْطِ وَلَا تُخْسِرُوا الْمِيزَانَ ﴿٢٩﴾

“Ai e ngriti edhe qiellin dhe Ai vuri drejtësinë. Që të mos kaloni kufirin në drejtësi. Edhe ju mbani me drejtësi peshoren e mos lini mangut në peshim!.”²⁶

Po ashtu i Gjithmëshirshmi në Librin e Tij famëlartë thotë:

²⁴ En-Nisa (4), ajeti 29.

²⁵ Esh-Shuara’ (26), ajetet 181-184.

²⁶ Err-Rrahman (55), ajeti 7-9.

وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِينَ ﴿٨٣﴾ الَّذِينَ إِذَا اكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ ﴿٨٤﴾

وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وَّزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ ﴿٨٥﴾

“Të mjerët ata që masin dhe peshojnë mangut. Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë, e kur u matin ose u peshojnë të tjerëve, u lënë mangut.”²⁷

Nga ajo që u cek më lart mbi çështjen e biznesit dhe etikën e tij, shohim se janë të përfshira të gjitha aspektet: vullneti i mirë, sinqeriteti në të gjitha kohërat, të masim gjërat me drejtësi, të punojmë pa mashtrime dhe së fundi t’i frikësohemi Allahut të Madhërishëm. Ai e di dhe shikon çdo gjë.

Nganjëherë e dimë se jemi në gjendje t’i shpëtojmë shikimit nëse veprojmë ndonjë vepër të keqe dhe të largohemi nga ato vepra të shëmtuara, mirëpo kur të mendojmë se Allahu është i pranishëm në të gjitha kohërat e në të gjitha çastet, e shohim se në realitet nuk mund t’i shmangemi kurrsesi pranisë së Tij. Ne nuk duhet të harrojmë assesi që Allahu i Plotfuqishëm vuri drejtësinë në çastin kur krijoi edhe qiellin.

²⁷ El-Mutaffifin (83), ajeti 1-3.

IX. PASURIA

Të qenurit i pasur është ëndërr dhe dëshirë e shumë njerëzve. Ka persona që mendojnë se nëse ndonjëherë u jepet rasti të zotërojnë para të mjaftueshme, nuk do të kenë më probleme. E vërteta është se vetëm njerëzit që e çmojnë paranë aq shumë mendojnë kështu. Kam bindjen se shumë më lehtë është ta kalojmë provimin e fatkeqësisë dhe mjerimit sesa provimin e zhvillimit dhe përparimit. Megjithatë, ka njerëz të cilët, kur sigurojnë prona të shumta, mendojnë se janë bërë zot në tokë. Kurani na e përshkruan shumë bukur tregimin e Karunit, kur tregon:

إِنَّ قَرُونَ كَانَ مِنْ قَوْمِ مُوسَىٰ فَبَغَىٰ عَلَيْهِمْ ۗ وَآتَيْنَاهُ مِنَ
الْكُنُوزِ مَا إِنَّ مَفَاتِحَهُ لَتَنُوءُ بِالْعُصْبَةِ أُولَى الْقُوَّةِ إِذْ قَالَ لَهُ
قَوْمُهُ لَا تَفْرَحْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْفَرِحِينَ ﴿٦٦﴾ وَابْتَغِ فِيمَا
ءَاتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ ۗ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا ۗ
وَأَحْسِنْ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ ۗ وَلَا تَبْغِ الْفُسَادَ فِي الْأَرْضِ ۗ
إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ ﴿٦٧﴾

“Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai e shtypte atë popull ngase Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri saqë

një grup i fuqishëm mezi bartnin çelësat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet i tha: “Mos u kreno aq fortë sepse Allahu nuk i do të shfrenuarit! Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos e lë mangut atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit’.”²⁸

Karuni ishte shumë i pasur, kryelartë dhe arrogant. Ishte i porositur që pasurinë e tij ta përdorte për qëllime dhe arsye të mira. Mirëpo përgjigja e tij ishte ashtu siç na e përshkruan edhe Kurani Famëlartë:

قَالَ إِنَّمَا أُوتِيتُهُ عَلَىٰ عِلْمٍ عِنْدِي ۗ أَوَلَمْ يَعْلَم أَنَّ اللَّهَ قَدْ
 أَهْلَكَ مِن قَبْلِهِ مِن قُرُونٍ مِّن قُرُونٍ مِّن هُوَ أَشَدُّ مِنْهُ قُوَّةً وَأَكْثَرَ
 جَمْعًا وَلَا يُسْأَلُ عَن ذُنُوبِهِمُ الْمُجْرِمُونَ ﴿٧٦﴾ فَخَرَجَ عَلَىٰ
 قَوْمِهِ فِي زِينَتِهِ ۗ قَالَ الَّذِينَ يُرِيدُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا يَا لَيْتَ
 لَنَا مِثْلَ مَا أُوتِيَ قُرُونُ إِنَّهُ لَذُو حَظٍّ عَظِيمٍ ﴿٧٧﴾

“Ai (Karuni) tha: ‘Më është dhënë (pasuria) vetëm në sajë të dijes sime!’ Po a nuk e di ai se Allahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë të tillë që ishin edhe më të fuqishëm edhe më të pasur se ai, po mëkatarët kriminelë as që do të pyeten për fajet e tyre (meqë Allahu e di). Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolinë e tij, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: ‘Ah, të

²⁸ El-Kasas (28), ajeti 76-77.

kishim pasur edhe ne siç i është dhënë Karunit, vërtet ai është fatbardhë!'. ”²⁹

Arroganca e tij ishte e tillë sa ai besonte se zotëronte dije të veçantë, duke lënë ndërkaq në harresë diturinë më të vlefshme mbi të gjitha, e ajo ishte njohja e Allahut.

Njerëzit kur e shikonin Karunin, dëshironin që të bëheshin si ai dhe të kenë fatin e tij. Ata nuk ishin fare në dijeni se Karuni kishte dështuar në provimin e mirëqenies dhe përparimit. Nga ky tregim kuranor mësojmë se të qenurit i pasur është sprovë, në të cilën shumica nga ne mund të dështojmë.

Pra edhe njëherë ta shohim mëshirën e Allahut xh.sh. ku thotë:

وَلَوْ بَسَطَ اللَّهُ الرِّزْقَ لِعِبَادِهِ لَبَغَوْا فِي الْأَرْضِ وَلَكِنْ يُنَزِّلُ بِقَدَرٍ

مَا يَشَاءُ إِنَّهُ بِعِبَادِهِ خَبِيرٌ بَصِيرٌ ﴿٢٧﴾

“Sikur Allahu t’ua shumonte begatinë robërve të vet, ata do t’i kalonin kufijtë, por Ai i furnizon me masë ata që dëshiron, sepse Ai është i njohur hollësisht dhe i dijshtëm për robërit e vet.”³⁰

Nga ky ajet mësojmë edhe arsyet përse disa prej nesh zotërojnë më pak pasuri e disa të tjerë më shumë. Gjëja më e mirë që duhet vepruar është që të falënderojmë Allahun për të mirat që na ka dhuruar, të kujdesemi për to dhe gjithashtu t’u ndihmojmë të varfërve.

Allahu xh.sh thotë:

²⁹ El-Kasas (28), ajetet 78-79.

³⁰ Esh-Shura (42), ajeti 27.

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَىٰ ﴿١﴾ وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّىٰ ﴿٢﴾ وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ
 ﴿٣﴾ إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّىٰ ﴿٤﴾ فَأَمَّا مَنْ أَعْطَىٰ وَاتَّقَىٰ ﴿٥﴾ وَصَدَقَ
 بِالْحُسْنَىٰ ﴿٦﴾ فَسَنِيَرُهُ لِلْيُسْرَىٰ ﴿٧﴾ وَأَمَّا مَنْ نَحَلَ وَاسْتَعْنَىٰ ﴿٨﴾
 وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَىٰ ﴿٩﴾ فَسَنِيَرُهُ لِلْعُسْرَىٰ ﴿١٠﴾ وَمَا يُغْنِي عَنْهُ مَالُهُ
 إِذَا تَرَدَّىٰ ﴿١١﴾ إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَىٰ ﴿١٢﴾

“Pasha natën që me errësirë mbulon gjithësinë! Pasha ditën kur ajo shkrepëtin! Pasha Atë që krijoi mashkullin e femrën! Vërtet, veprimi juaj është i llojlojtë. E, sa i përket atij që jep e ruhet dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të lehtë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe e ndienë veten të pavarur (nga Zoti), e që përgënjeshton më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën. E pasuria e tij nuk do t’i bëjë dobi, kur ai të zhduket. Detyrë e jona është vetëm të udhëzojmë.”³¹

Pasurinë duhet ta vlerësojmë e ta përdorim në bilanc të mirë. Pasi që e dimë se ajo vjen nga Krijuesi i Gjithësisë, doemos duhet ta përdorim për vepra dhe qëllime të mira dhe njëherazi të jemi falënderues ndaj Allahut që na ka pasuruar. Pasi t’i kemi plotësuar këto kushte, atëherë kemi pasuar rrugën e drejtë. Mirëpo, nëse e grumbullojmë atë dhe nuk kujdesemi për të varfërit dhe nevojtarët, atëherë kemi marrë rrugën e gabuar.

³¹ El-Lejl (92), ajeti 1-12.

10. Të folurit

X. TË FOLURIT

Në botën e sotme, telekomunikimi është zhvilluar dhe përshpejtuar shumë, por shumë gjëra që fliten në realitet nuk janë aspak të vërteta. Shumë shpesh ndodh që derisa e vërteta të shpaloset, bëhet shumë vonë dhe dëmet e shkaktuara janë të mëdha e të paevitueshme. Është shumë me rëndësi që para se të flasim, të jemi të sigurt se ajo që do të themi të jetë e vërtetë dhe me këtë nuk mbartim ndonjë lloj trillimi apo gjëra të shpikura, siç ndodh me ca njerëz që për motive personale trillojnë tregime e shpifje të ndryshme. Veç kësaj, ndodh që të flasim pas shpinës së njerëzve, sepse nuk kemi guxim t'ua themi në sy çfarë na shqetëson. Nganjëherë edhe i tallim. E vërteta pikëlluese është se kur flasim për njerëzit, bëhemi shumë të pavetëdijshëm, duke mos i vërejtur dëmet që shkaktojmë. Nganjëherë bisedat na çojnë deri aty sa t'i lëndojmë njerëzit shumë keq. T'i hedhim një sy ajetit:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اِنْ جَاءَكُمْ فٰسِقٌ بِّنَبَاٍ فَتَّبَيَّنُوْا اَنْ تُصِيبُوْا قَوْمًا

بِجَهْلٍ ۗ فَتُصِيبُوْا عَلٰٓى مَا فَعَلْتُمْ تَنْدَمِيْنَ ﴿٦﴾

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, që të mos e

goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për ç'keni vepruar.”³²

Ajeti i lartpërmendur, na mëson qartazi se kur të marrim ndonjë lajm, doemos duhet të sigurohemi se vërtetë lajmi apo informata e dhënë është e vërtetë, përndryshe mund të shkaktojmë dëme dhe vuajtje të mëdha. Është e rrugës që ta bëjmë shprehi rikonfirmimin dhe vërtetësinë e çdo gjëje që na është thënë dhe pasi të jetë konstatuar se ajo është e vërtetë, atëherë mund të flasim rreth asaj çështje çfarëdoqoftë ajo. Mirëpo në rast se nuk jemi aq të sigurtë rreth saj, është mirë që të heshtim e të mos flasim fare, për arsye se edhe duke pasur qëllime mjaft të mira dhe të pastërta, ato mund të lëndojnë njerëzit e bile lëndimet që i shkaktojmë, nuk munden as të evitohen.

Allahu xh.sh. thotë:

يَتَّيِبُهُمُ اللَّهُ لِيَأْتِيَهُمْ خَيْرٌ مِّنْ قَوْمٍ عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا
مِّنْهُمْ وَلَا نِسَاءٌ مِّنْ نِّسَاءِ عَسَىٰ أَن يَكُنَّ خَيْرًا مِّنْهُنَّ وَلَا تَلْمِزُوا
أَنفُسَكُمْ وَلَا تَنَابَزُوا بِاللِّغَابِ بِئْسَ الْأَسْمُ الْفُسُوقُ بَعْدَ الْإِيمَانِ
وَمَن لَّمْ يَتُبْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٤٩﴾

“O ju që besuat, nuk është mirë që një popull të tallet me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga përqeshësit, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që të përqeshurat të jenë më të mira se përqeshëset; dhe mos e etiketoni njëri-tjetrin me

³² El-Huxhurat (49), ajeti 6.

*llagape. Pas besimit është keq që të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen janë mizorë.*³³

Kur tallemi me njerëz, përqeshim dikë apo i etike-tojmë ata me ndonjë llagap të papëlqyer, të gjitha këto i marrim si të lehta. Duhet pasur parasysh se ka njerëz të cilët vërtetë janë sarkastik dhe pa marrë parasysh se a janë në dijeni apo jo, ata me sarkazmën e tyre i lëndojnë njerëzit shumë thellë. Nga ajeti i lartshënuar shohim Madhërinë e Krijuesit, që kujdeset për ne edhe në çështjet e imëta të jetës sonë të përditshme.

Pavarësisht nga ajo nëse përqeshëm të tjerët apo qemë objekt i përqeshjes, në të dy rastet do të lëndohemi. Kur përqeshim njerëzit, kemi bërë gjynah dhe, herët ose vonë, padyshim do të dënohemi për gjynahet e bëra. Ndërsa përse i përket rastit të dytë, jemi ne ata që lëndohemi, për arsye se kur njeriu të merret si objekt talljeje dhe përqeshjeje, është vërtet një gjë e pakëndshme. Për pasojë, mund t'u shkaktojmë njerëzve vuajtje, ku si rrjedhim mund të shkohet deri aty sa njeriu t'i japë fund që kurrë më të mos takohet me askënd. Kurani Famëlartë na e tërheq vërejtjen në lidhje me këto vese të shejtanit, në mënyrë që të jemi më të vetëdijshëm mbi atë që është e mirë dhe e keqe.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ
إِثْمٌ وَلَا تَجَسَّسُوا وَلَا يَغْتَب بَّعْضُكُم بَعْضًا أَن تُحْبِبُوا أَحَدُكُمْ أَنَّ

³³ El-Huxhurat (49), ajeti 11.

يَا كُلَّ لَحْمٍ أَخِيهِ مَيِّتًا فَكْرَهْتُمُوهُ^٤ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ

رَّحِيمٌ

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë gjynah; mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit e mos përgjoni njëri-tjetrin; mos dëshiron ndonjëri prej jush që të hajë mishin e vëllait të tij të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai e pranon shumë pendimin.”³⁴

Nganjëherë kur bëhem dyshuese, e ndiej sikur shejtani është afër meje. Do të thosha se përgjimi është edhe më i keq, për arsye se kur dikush përgjon dikë është mendim shumë i keq, të cilin e pasojnë veprat e këqija, kështu që përfundojmë së foluri pas shpinës së njerëzve, ndërsa ata nuk janë në gjendje të mbrohen. Ne gjithsesi duhet t’u shmangemi sjelljeve të tilla. Ju lutem, kushtojini vëmendje këtyre ajeteve, pasi të gjitha i janë drejtuar besimtarëve, duke thënë: *“O ju që keni besuar!”* Këto janë disa veti e veçori që duhet t’i mënjanojmë me përqaftimin e fesë islame. Si mund të themi që besojmë në Zotin e përsëri vazhdojmë të sillemi sikur s’ka Zot? Të përgojojmë të tjerët pa vërtetuar nëse ajo që themi është e vërtetë apo jo. Po ashtu, kur dyshojmë në diçka apo flasim keq për të tjerët, përqeshim, merremi me fjalë të ndyta, i etiketojmë njerëzit me llaçape dhe nofka të papëlqyeshme, të gjitha këto i ngjasoj-

³⁴ El-Huxhurat (49), ajeti 12.

në ngrënies së mishit të vëllait tonë për së vdekuri. Jam e bindur se askush prej nesh nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë.

11. Fugia e fjalëve

XI. FUQIA E FJALËVE

Edhe fjalët janë një aspekt shumë i rëndësishëm i jetës sonë të përditshme. Disa njerëz vetëm flasin, disa nuk flasin aq shumë e ka të tjerë që flasin pa masë. Sido që të jetë, këtu nuk është me rëndësi se sa flasin, shumë a pak, ajo që ka rëndësi në këtë temë është se çfarë flasin. Gjithmonë duhet të kemi kujdes rreth fjalëve që përdorim, për arsye se lidhjet familjare mund të prishen si rezultat i fjalëve. Fjalët janë aq të ndjeshme saqë mund të lëndojnë personin tjetër apo mund të sjellin humbjen e shokëve, madje edhe të afërmeve tanë.

Pa dyshim, falja është gjithmonë e mundshme, por a mundet dikush ta hapë zemrën e tij përsëri pasi t'ia ketë lënduar dikush, duke bërë që ajo të pikojë gjak? Në Kuran kemi një parabolë shumë të bukur lidhur me fjalët:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ
وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ ﴿٦٧﴾ تُؤْتِي أُكْلَهَا كُلَّ حِينٍ بِإِذْنِ رَبِّهَا وَيَضْرِبُ
اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٦٨﴾ وَمَثَلُ كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ
كَشَجَرَةٍ خَبِيثَةٍ اجْتُثَّتْ مِنْ فَوْقِ الْأَرْضِ مَا لَهَا مِنْ قَرَارٍ ﴿٦٩﴾

“A nuk e ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në

tokë) e degët e saj janë lart, e që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. Allahu, pra, u parashtron njerëzve shembuj, që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe është si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar.”³⁵

وَقُلْ لِعِبَادِي يَقُولُوا الَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْزِعُ بَيْنَهُمْ

إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ لِلْإِنْسَانِ عَدُوًّا مُّبِينًا ﴿٥٧﴾

“E ti thuaju robëve të Mi: ‘Le ta thonë atë që është më e mira, sepse shejtani ndërsen mes tyre e dihet që shejtani është armik i hapët i njeriut.’”³⁶

Do të ishte mirë sikur ta kishim ngulitur në mendje këtë parabolë të bukur kuranore dhe më pas do të kishim vërejtur fuqinë që zotërojnë fjalët, në formën e pemës së mirë me shumë fruta; asnjëherë nuk duhet harruar se ç’mund të sjellin fjalët e këqija. Gjithmonë duhet ta kemi parasysh porosinë e Allahut të Madhërishtëm që të përdorim vetëm fjalë të mira; përndryshe do të gremisemi në duart e shejtanit.

Jemi të porositur gjithashtu që të flasim në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në fakt, nëse flasim me shprehje të cilat përmbajnë më shumë se një kuptim përdorimi i tyre do t’i çorientojë njerëzit në kahje të ndryshme.

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

³⁵ Ibrahim (14), ajetet 24-26.

³⁶ El-Isra (17), ajeti 53.

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ﴿٧٠﴾ يُصْلِحْ
لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَاللَّهُ وَرَسُولُهُ فَكَدَّ
فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧١﴾

“O ju besimtarë, pëmbajuni mësimëve të Allahut dhe
thuani fjalë të drejta. Ai (Allahu) ju mundëson të bëni
vepra të mira dhe ju shlyen gjynahet, e kush e respek-
ton Allahun dhe të dërguarin e Tij ka arritur sukses të
madh.”³⁷

Duke e bërë të sigurtë se atë që e themi, është e çil-
tër, e drejtë dhe e vërtetë dhe duke mos u sjellur rreth e
rrotull, do të arrijmë që t’i mënjanojmë të gjitha llojet e
keqkuptimeve. Në të njëjtën kohë, duhet shtuar se fja-
lët e mira janë shumë me rëndësi.

Allahu i Madhërishëm thotë:

قَوْلٌ مَّعْرُوفٌ وَمَغْفِرَةٌ خَيْرٌ مِّنْ صَدَقَةٍ يَتَّبِعُهَا أَذَىٰ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ
حَلِيمٌ ﴿٢٦٣﴾

“Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit)
është më e dobishme se lëmosha që përcillet me të keqe.
Allahu nuk ka nevojë për askënd, Ai është i butë.”³⁸

Nga ky ajet shohim rëndësinë që i është kushtuar fja-
lëve të mira si dhe mbikëqyrjes së gabimeve të njerëzve
kur lëmoshat e tyre përcillen me të keqe. Si rrjedhim,

³⁷ El-Ahzab (33), ajetet 70-71.

³⁸ El-Bekare (2), ajeti 263.

nëse vërejmë në vetvete shtysa që të themi fjalë të vrazhda apo t'i shikojmë gabimet e të tjerëve, ne duhet të përmbahemi, duke përdorur në vend të shprehjeve të papëlqyeshme fjalë të mira.

12. Fremtímet

XII. PREMTIMET

Pothuajse çdo ditë, si rezultat i rrethanave të ndryshme, ne u premtojmë njerëzve se do t'i takojmë në ditët e ardhshme apo në një kohë tjetër, në javën apo në muajin e ardhshëm! Kjo nuk është asgjë tjetër veçse premtim, as më shumë e as më pak dhe prapë konsiderohet gabim, për arsye se shumë gjëra i marrim si të mirëqena e të garantuara. I premtojmë dikujt se do të pjekim një tortë apo do t'i ndihmojmë me detyra të përditshme. Sillemi sikur të ishim të sigurtë se e nesërnja do të na gjejë të gjallë dhe, duke vepruar në këtë mënyrë, e marrim jetën si të garantuar e s'ia dimë vlerën dhe rëndësinë që ka. Ne jemi mendjemëdhenj, thua se çdo gjë varet nga ne dhe dëshira jonë mjafton për ta mbajtur premtimin. Sikur ta dinim, do të kuptonim se çdo akt i thjeshtë në jetë, aq sa edhe ngritja e gishtit varet nga Krijuesi dhe Sunduesi i kësaj gjithësie.

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

وَلَا تَقُولَنَّ لِشَايٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَٰلِكَ غَدًا ﴿١٢١﴾ إِلَّا أَن يَشَاءَ اللَّهُ

وَأَذْكُرَنَّ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ وَقُلْ عَسَىٰ أَن يَهْدِيَنِّي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِنِّ

هَٰذَا رَشْدًا ﴿١٢٢﴾

“Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: ‘do ta bëj këtë nesër!’ Thuaj vetëm: ‘Në dashtë Allahu!’ E kur të

*harrosh, përmende Zotin tënd e thuaj: 'Shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt se ky.'*³⁹

Nga ajetet e lartpërmendura duhet të mësojmë se çdoherë kur t'u premtojmë njerëzve, duhet shtuar edhe pjesa e ajetit "Në dashtë Allahu!" Vetëm në këtë mënyrë, kuptojmë se çdo gjë qëndron në duart e Allahut, prandaj nuk kemi përse të brengosemi, pasi që tashmë jemi mbështetur në diçka të vërtetë e të drejtë. Nëse hasim në harresë të këtij ajeti, atëherë duhet kërkuar ndihmë nga Allahu që të na udhëzojë më shumë herëve të tjera.

Në anën tjetër, sa më shumë që të shtojmë "Në dashtë Allahu" aq më shumë duhet patur kujdes që çdo gjë që veprojmë të jetë brenda kornizave të mundësive tona, në mënyrë që të arrijmë në takime në kohë, t'i mbajmë premtimet si dhe çdo gjë që kemi marrë përsipër.

Allahu xh.sh thotë:

وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ
تَوْكِيدِهَا وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ عَلَيْكُمْ كَفِيلًا إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا

تَفْعَلُونَ ﴿١٨﴾

"Meqë keni premtuar, zbatojeni premtimin e dhënë Allahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar

³⁹ El-Kehf (18), ajetet 23-24.

ato, duke qenë se Allahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, Allahu e di se çfarë punoni.”⁴⁰

Ajo që duhet të kuptojmë këtu është se, saherë që t'i premtojmë ndokujt, duhet pasur në mendje se Allahu është dëshmitar për atë që gjuha jonë e shqipton, prandaj asnjëherë nuk duhet që t'i thyejmë betimet dhe premtimet e dhëna, pa marrë parasysh se çfarë janë rrethanat.

⁴⁰ En-Nahl (16), ajeti 91.

13. Gënjeshtra

XIII. GËNJESHTRA

Gënjeshtra është gjëja më e lehtë që njeriu mund të bëjë. Ndërmjet gënjeshtrës dhe të qenurit i sjellshëm gjendet një ndarje shumë e mirë dhe këtë lloj të gënjeshtrës e quajmë “gënjeshtrë pa të keq” (*white lie*), mirëpo në gënjeshtrën e tillë ekziston një kthim madhor. Për më tepër, të rriturit e kuptojnë dallimin në mes të qenit i sjellshëm e të qenit gënjeshhtar, mirëpo të vegjëlit nuk e dallojnë fare. Prandaj, ajo që ndodh këtu është se qysh nga mosha e vogël fëmija është i mësuar të mos gënjejë, përderisa në të njëjtën kohë ai shikon prindërit e tij duke gënjyer dhe duke jetuar me gënjeshtrën. Duhet që doemos të zotërojmë një përkufizim të qartë të fjalës “gënjeshtrë” e ai është formulim i gabuar qëllimisht⁴¹, ndaj nuk duhet ta pranojmë, pasi e dimë se për çfarë përdoret. Vetëm atëherë mund t’i mësojmë fëmijët tanë mbi vlerat dhe rëndësitë që janë të llojllojshme dhe paralelisht me veprat tona. Kurani e shpjegon shumë bukur se ç’ndodh kur njerëzit gënjejnë:

هَلْ أَنْتُمْ عَلَىٰ مَنْ تَنَزَّلُ الشَّيْطِينُ ﴿٣١﴾ تَنَزَّلُ عَلَىٰ كُلِّ أَفَّاكٍ
أَثِيمٍ ﴿٣٢﴾ يُلْقُونَ السَّمْعَ وَأَكْتَرُهُمْ كَذِبُونَ ﴿٣٣﴾

⁴¹ The Concise Oxford Dictionary, f. 625.

“A t’ju tregoj se kujt i vijnë djajtë? Ata i vijnë çdo gënjeshtari e mëkatari. (U vijnë) dhe hedhin dëgjimin - shumica e tyre gënjejnë.”⁴²

Ashtu si bletët që shkojnë te lulet, edhe djajtë shkojnë te gënjeshtarët. Dhe në çastin kur gënjejmë, pa dyshim ajo duhet mbuluar me gënjeshtren tjetër dhe në këtë mënyrë gënjeshttra vazhdon.

Në vazhdim do të sjellim një parabolë shumë të bukur kuranore:

وَالشُّعْرَاءُ يَتَّبِعُهُمُ الْغَاوُونَ ﴿٢٢٤﴾ أَلَمْ تَرَ أَنَّهُمْ فِي كُلِّ وَادٍ
يَهيمُونَ ﴿٢٢٥﴾ وَأَنَّهُمْ يَقُولُونَ مَا لَا يَفْعَلُونَ ﴿٢٢٦﴾

“E për sa u përket poetëve (që Muhammedi nuk është i tillë), ata i ndjekin të humburit (nga e vërteta). A nuk sheh se ata hidhen në çdo anë (herë lavdërojnë, herë për-qeshin). Dhe ata janë prej atyre që flasin atë që s’e veprojnë.”⁴³

Si një poet që shkruan për arsye të shkrimit dhe nuk ka për qëllim atë që shkruan. Shkrimet e tij nuk shërbejnë për asnjë synim dhe për këtë janë të paqëllimta; kjo i ngjan qëndrimit tonë në një luginë me shumë shtigje, ku fare shpejt mund të humbasim. Si rrjedhojë, gënjeshttra apo rrena nuk duhet të merret si çështje e thjeshtë, prandaj edhe duhet të mosaprovohet.

⁴² Esh-Shuarau (26), ajetet 221-223.

⁴³ Esh-Shuarau (26), ajetet 224-226.

14. Djalli

XIV. DJALLI

Një prej problemeve më të mëdha me të cilin njeriu është ballafaquar qysh nga fillimi i krijimit të tij e deri në ditët tona, është Djalli apo më mirë të themi Shejtani. Njeriu i parë, Ademi dhe gruaja e tij Hava [alejhimuselam], jetonin në kopshtet e lumturisë. Shejtani i provokoi ata dhe më pas ata pasuan Djallin e mallkuar. Shtrohet pyetja: a kishin ngrënë ata nga pema? A i ishin afruar ata pemës së ndaluar? Ç'gjynah kishin bërë? Ata kishin bërë gjynah vetëm në një çështje; ata s'i ishin nënshtruar Krijuesit të tyre dhe si rrjedhojë kishin braktisur rrugën e devotshmërisë. Veprimi i tillë ishte një turpërim.

Është turp kur njeriu sillet në mënyrë të gabuar, është turp nëse nuk pasojmë urdhrat e Krijuesit tonë dhe gjithashtu është turp kur njeriu sillet kundër bukurisë së natyrës në të cilën jemi krijuar. Ky është edhe shkaku përse disa njerëz të kapur duke kryer vepra të këqija, dhe kur kamera mundohet të mësojë të fshehtën e tyre, i shohim se si mbulojnë fytyrat:

يَبْنِي ۚ آدَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمْ الشَّيْطَانُ كَمَا أَخْرَجَ أَبْوَيْكُمْ مِنَ الْجَنَّةِ
يَنْزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوْءَٰتِهِمَا ۗ إِنَّهُ يَرَنَّكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ

مَنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ إِنَّا جَعَلْنَا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ لِلَّذِينَ لَا

يُؤْمِنُونَ

“O bijtë e Ademit, të mos ju mashtrojë Shejtani në asnjë mënyrë, siç i nxori prindërit tuaj nga xhenneti, ua hoqi petkun që t’u dilte në shesh lakuriqësia. Vërtet ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk i shihni. Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë.”⁴⁴

Ajo që duket e pakuptimtë nga ana jonë është një e vërtetë e thjeshtë se ne ende s’e kemi braktisur xhennetin; ne ende jemi duke jetuar në të deri kur ta pasojmë shejtanin.⁴⁵

Shtrohet pyetja se si na afrohet shejtani? Ai gjithmonë është përreth nesh, në të gjitha format dhe përbërjet, nganjëherë në formë epshi, fuqie, pasurie, varfërie, gjithnjë duke krijuar tek ne dëshira e qejfe të gabuara, duke na pëshpëritur në zemra dhe kur të shfaqet në formën e tij të njëmendtë, atëherë ai është shumë i rrezikshëm. Dikush do të kishte pyetur se cila është forma dhe pamja e tij e vërtetë? Ajo është arroganca, mendjemadhësia. A nuk besojmë nganjëherë se jemi më të mirë se të

⁴⁴ El-A’raf (7), ajeti 27.

⁴⁵ Është shumë me rëndësi t’u tregojmë lexuesve se njeriu është krijesë e Allahut xh.sh. dhe si i tillë nga mësimet dhe sprovat gjatë jetës së tij përfiton përvojë të çmueshme. Mirëpo armiku i betuar i njerëzimit zotëron përvojë të lashtë sa edhe vetë krijimi i mbarë njerëzimit. Ai është krijuar para njeriut, dhe ka xhelozin ndaj nesh, ai është mallkuar nga Allahu dhe qysh nga ajo ditë punon e përpiket që me tërë metodat dhe dredhitë që di, ta nxjerrë njeriun nga rruga e drejtë, ndaj nga ne kërkohet që të përgatitemi që t’u bëjmë ballë kurtheve e pëshpëritjeve të shejtanit. (*shën. përk.*)

tjerët, kur kryejmë këtë apo atë punë? Apo, a na është dhënë rasti që një ditë të tregohemi drejtues e menaxherë më të mirë sesa shefat dhe menaxherët tanë e kështu me radhë? E vërteta është se ne si qenie njerëzore, në të vërtetë jemi të pafuqishëm dhe sa më shumë që të na dhurojë Krijuesi, aq më të përulur e modestë duhet të tregohemi. Prandaj edhe nuk jemi në gjendje që zgjuarsisë sonë t’ia japim formën dhe trajtën, koeficientin tonë të inteligjencës.

Kemi dëshirë të besojmë se jemi në gjendje t’i japim formën, mirëpo në realitet nuk jemi. Është fakt se ne nuk jemi të zotë të lëvizim madje edhe një hap në të djathtë apo në të majtë, veçse me dëshirën e Allahut! Si mund ta hetojmë kur jemi veshur me petkun e mendjemadhësisë dhe më pas ta ndreqim veten nga kjo e mëtej? Për të vërejtur se vërtetë jemi bërë kryeneçë, mendjemëdhenj, arrogantë, më së miri e dimë kur tregohemi më të përsosur dhe më të mirë se filani; atëherë kur mendojmë se nuk kemi nevojë për Zot, kur bindja jonë merr kahje të kundërt dhe besojmë se jemi të pavarur, të vetëkënaqur e çdo gjë që ndodh në gjithësi është rastësi apo ‘koinçidencë’. Fjala ‘koinçidencë’ është fjalë e shpikur nga njerëzit që nuk besojnë në Allahun, Krijuesin e gjithësisë. Ata mendojnë se për punët dhe veprat e tyre nuk do merren në llogari. Ç’do të ndodhë me ne nëse tregojmë kryelartësi?

Ja se ç’thotë Krijuesi ynë lidhur me këtë:

سَأَصْرِفُ عَنْ آيَاتِيَ الَّذِينَ يَتَكَبَّرُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ
وَأَنْ يَرَوْا كُلَّ آيَةٍ لَا يُؤْمِنُوا بِهَا وَإِنْ يَرَوْا سَبِيلَ الرُّشْدِ لَا
يَتَّخِذُوهُ سَبِيلًا وَإِنْ يَرَوْا سَبِيلَ الْغَيِّ يَتَّخِذُوهُ سَبِيلًا ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ
كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا وَكَانُوا عَنْهَا غَافِلِينَ ﴿٤٦﴾ وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا
وَلِقَاءِ الْآخِرَةِ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ هَلْ يُحْزَنُونَ إِلَّا مَا كَانُوا
يَعْمَلُونَ ﴿٤٧﴾

“Unë do t’i zmbrops nga argumentet e Mia ata të cilët pa pasur të drejtë bëjnë kryelartësi në tokë, të cilët edhe nëse shohin çdo argument nuk besojnë, edhe nëse shohin rrugën e shpëtimit nuk e ndjekin, e nëse shohin rrugën e gabuar ata e ndjekin atë rrugë. Ata e bëjnë këtë (verbërim të tyre), ngase ata i konsideruan të rreme faktet Tona dhe ngase i lanë pas dore. Ata të cilët i mohuan argumentet Tona dhe takimin në ditën e botës së ardhshme asgjësuan veprat e tyre. A shpërblehen ata (me sevap ose me dënim) përveçse sipas asaj që kanë vepruar?”⁴⁶

Ajetet e mësipërme shpjegojnë në mënyrë të detajuar shkaqet se si, kur bëjnë gabime, njerëzit asnjëherë nuk pranojnë të jenë fajtorë apo të kenë vepruar keq. Shejtani i bën të besojnë se çfarëdo që veprojnë është e drejtë. Nga mëshira e madhe e Allahut për robërit e Tij është edhe zbritja e Kuranit përmes të cilit jemi në gjendje të dimë se a veprojmë mirë apo keq, prandaj shenjat janë në të që ne të shikojmë e të bazohemi në

⁴⁶ El-A’raf (7), ajetet 146-147

to. Një mirësi e vogël çdo ditë është e vyer për shpirtin tonë.

Kurrresi nuk duhet që të gremisemi në duart e Shejtanit, apo të themi se për disa arsye biem në duart e Shejtanit, të themi se faji është i yni apo si shkak i disa faktorëve të jashtëm; atëherë çfarë të veprojmë më tutje kur të kemi rënë në duart e Shejtanit?

E para, përgjigja është aq e thjeshtë saqë vështirë të besohet: dil përjashta e qëndro në shi! Po, qëndro në shi sa më shumë që është e mundur dhe sa më shpesh që ke mundësi.

Në Kuran kemi zbuluar edhe këtë mrekulli:

إِذْ يُغَشِّيكُمُ النُّعَاسَ أَمَنَةً مِّنْهُ وَيُنزِلُ عَلَيْكُم مِّنَ السَّمَاءِ مَاءً

لِيُطَهِّرَكُم بِهِ وَيُذْهِبَ عَنْكُم رَجَزَ الشَّيْطَانِ وَلِيَرْبِطَ عَلَىٰ

قُلُوبِكُمْ وَيُثَبِّتَ بِهِ الْأَقْدَامَ ﴿٨١﴾

“Dhe kur Ai ju kaploi me një kotje (gjumë) që ishte siguri për ju nga ana e Tij, ju lëshoi shi nga qielli për t’ju pastruar, largoi prej jush cytjet e shejtanit, që kësh-tu të fuqizojë bindjen në zemrat tuaja dhe t’ju për-forcojë me të (shiun) këmbët tuaja.”⁴⁷

Ajetet në fjalë u bënë edhe më të qarta për mua ditën kur po kërkoja përgjigjen rreth mbytjes së një personi dhjete vite më parë, këtu në Malajzi. Kam dëgjuar nga disa njerëz që besojnë se personi ishte prekur nga Shejtani. Duke u munduar që t’ia largojnë

⁴⁷ El-Enfal (8), ajeti 11

Shejtani nga trupi, e kishin rrahur aq shumë saqë i kishin shkaktuar vdekjen. Përgjigja në këtë ajet është shumë e qartë. Për ta larguar shejtani nga trupi, nevojitet shiu. Allahu është i Madh, Ai na dhuron aq shumë dhe prapëseprapë kur bie shi, shohim njerëzit duke mbuluar kokat, duke vrapuar në kërkim të strehës, duke përdorur çadra etj. Shohim njerëzit e rritur duke vepruar një gjë të zakonshme, mirëpo të shikojmë fëmijët?! Ata janë në gjendje të lozin me orë të tëra në shi dhe janë tejet të lumtur të vazhdojnë në këtë gjendje.

E dyta: Nëse ndihemi se jemi të prekur nga shejtani, atëherë duhet ta lexojmë këtë lutje të thjeshtë kuranore:

وَقُلْ رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيْطَانِ ﴿٧٧﴾ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ

أَنْ مَّحْضُرُونَ ﴿٧٨﴾

“Dhe thuaj: ‘O Zot i im, unë mbrohem me Ty prej cytjeve të djajve! Dhe mbështetem te Ti që ata të mos më afrohen!’”⁴⁸

Këto janë fjalë shumë të thjeshta për t’u shqiptuar në raste kur ndihemi se nuk jemi plotësisht vetja. Këto dy ajete duhet të lexohen gjithashtu edhe në rastet kur në zemrat e mendjet tona hyjnë të gjitha llojet e mendimeve dhe parandjenjave negative. Duke iu mbështetur Zotit, bëhemi të sigurtë nga pëshpëritjet dhe ngacimet e shejtanit.

⁴⁸ El-Mu’minun (23), ajetet 97-98.

15. Suxhozi dhe pijet alkoolike

XV. BIXHOZI DHE PIJET ALKOOLIKE

Nga metodat e tjera që përdor Shejtani për t'i humbur njerëzit është edhe përdorimi i pijeve alkoolike e bixhozi. A ka dëgjuar dikush ndonjëherë gjëra të mira që sjellin bixhozi e pijet dehëse? Kurrë, që të dyja këto dukuri duken që mbarojnë me një përfundim të ngjashëm: familja lihet në harresë, shkatërrohet dhe çdo gjë shuhet.

Cila është këshilla e Krijuesit për ne?

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ قُلْ فِيهِمَا إِثْمٌ كَبِيرٌ وَمَنْفَعٌ
لِلنَّاسِ وَإِثْمُهُمَا أَكْبَرُ مِنْ نَفْعِهِمَا ۗ وَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ
قُلِ الْاَعْفُو كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللهُ لَكُمْ الْاٰيٰتِ لَعَلَّكُمْ تَتَفَكَّرُونَ

“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: ‘Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre.’ Të pyesin ty edhe se ç’do të japin. Thuaju: ‘Tep-ricën’! Kështu jua sqaron Allahu argumentet ashtu që të mendoni (çka është e mirë e çka është e keqe).”⁴⁹

Po ashtu në suren El-Maide, Allahu xh.sh. thotë:

⁴⁹ El-Bekare (2), ajeti 219.

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْحَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَمُ
 رَجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٩١﴾ إِنَّمَا
 يُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ يُوقِعَ بَيْنَكُمُ الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ فِي الْحَمْرِ
 وَالْمَيْسِرِ وَيَصُدَّكُمْ عَن ذِكْرِ اللَّهِ وَعَنِ الصَّلَاةِ فَهَلْ أَنْتُمْ مُنْتَهُونَ

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës e bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po u jepni fund (alkoolit e bixhozit)?.”⁵⁰

Kurani na tregon gjerësisht se konsumimi i pijeve alkoolike, bixhozi, llojet e drogave, të gjitha këto janë shpikje dhe sajime të Shejtanit, prandaj qëllimi i tij është që nëpërmjet tyre të sjellë urrejtje, armiqësi dhe përçarje në mes nesh. Sa e sa martesë janë prishur si rezultat i këtyre veprave të ndyra? Sa fëmijë gjenden nëpër spitale si shkak i rrahjes nga prindërit e tyre pjanecë? Sa gra duhet të vuajnë për shkak se i kanë burrat përdorues të alkoolit, drogës e bixhozit? Kemi edhe gra të cilat konsumojnë alkoolin, thua se në të gjitha sëmundjet shoqërore nuk ka dallim mes mashkullit dhe femrës... është vërtetë për t’u pikëlluar. Kur njeriu konsu-

⁵⁰ El-Maideh (5), ajetet 90-91.

mon alkool, drogë, ai harron edhe ekzistimin e Allahut, pasi që i dehuri nuk di çfarë bën, ndaj edhe nuk jemi të obliguar për t'u falur. E tërë kjo vjen si rezultat i asaj se njeriu i dehur nuk mund të kontrollojë mendjen dhe nuk di se ç'flet përderisa është i dehur.

Po ashtu kryerja e namazit nga këta njerëz, në rrethana të tilla nuk ka fare kuptim, për arsye se të falurit është koha në të cilën njeriu gjatë kryerjes së tij, komunikon me Zotin pa ndërmjetës. Lidhur me këtë, Fuqiploti thotë:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَقْرَبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَرَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا
مَا تَقُولُونَ وَلَا جُنُبًا إِلَّا عَابِرِي سَبِيلٍ حَتَّىٰ تَغْتَسِلُوا وَإِنْ كُنْتُمْ
مَّرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِنَ الْغَايِبِ أَوْ لِمَسَمْتُمْ
الْأَسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا
بِأَيْدِيكُمْ وَأَيْدِيكُمْ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَفُورًا غَفُورًا ﴿٤٣﴾

“O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flitni, e as duke qenë xhunubë (të papastër) derisa të laheni, me përjashtim kur jeni udhëtarë. Nëse jeni të sëmurë, jeni në udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen nga ultësira (nevojtorja) apo keni prekur gratë e nuk gjeni ujë, atëherë prekeni dheun dhe fërkoni me të fytyrat dhe duart (për tejemmum). Allahu shlyen e falë mëkatet.”⁵¹

⁵¹ En-Nisa (4), ajeti 43.

Nga ky ajet kuranor mësojmë dy aspekte të rëndësishme; aspekti i parë është nevoja për të ditur se çfarë themi gjatë kryerjes së namazeve, ndërsa aspekti i dytë ka të bëjë me pastërtinë personale.

16. Higijena vetjake

XVI. HIGJIENA VETJAKE

Të qenurit i pastër është jashtëzakonisht me rëndësi për jetën e njeriut, pasi edhe përhapja e shumë sëmundjeve është rezultat i rrobave të papastra. Në vazhdim do të sjellim një ajet kuranor, i cili në mënyrë të qartë na mëson mbi pastërtinë dhe mënyrën e saj:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ
وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى
الْكَعْبَيْنِ وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ
أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِنَ الْغَايِبِ أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً
فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِّنْهُ مَا
يُرِيدُ اللَّهُ لِيَجْعَلَ عَلَيْكُمْ مِّنْ حَرَجٍ وَلَٰكِنْ يُرِيدُ لِيُطَهِّرَكُمْ وَلِيُتِمَّمَ
نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٦﴾

“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lajini deri te kyçet. Nëse jeni xhumubë, atëherë pastrohuni (lahuni)! Në qoftë se jeni të sëmurë, ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni

kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë prekeni dheun e pastër e me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja (për tejemum). Allahu nuk dëshiron (me obligimin për abdest e larje) t'ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë (prej gjynaheve), ta plotësojë të mirën e Tij ndaj jush e që t'i falënderoheni.”⁵²

Ajeti i përmendur na porositë që pas kontakteve intime me gratë të pastrohemi, të pastrohemi edhe pasi të kemi përdorur banjën. Të pastrojmë duart, bërrylat, fytyrat, t'i fërkojmë kokat dhe t'i pastrojmë këmbët, të gjitha këto pjesë duhet të lahen para se të fillojmë faljen e namazit.

Nga këto ajete gjithashtu mësojmë se dëshira e Allahut është që ne të jemi të pastër dhe që mos të na japë vështirësi. Nëse pyesim çfarëdo mjeku mbi vlerën dhe rëndësinë e të qenurit i pastër, ai patjetër do jetë në gjendje ta shpjegojë rëndësinë e pastërtisë. Përderisa disa njerëz zbatojnë pastërtinë vetjake, disa të tjerë fatkeqësisht as që brengosen. Si rrjedhojë shprehia dhe natyra e njeriut rreth pastërtisë duhet të bëhet pjesë e përditshmërisë sonë.

Nevoja për t'u pastruar dhe për t'u bërë gati për namaz mbart kuptim dhe domethënie shpirtërore; duhet të pastrohemi nga të gjitha papastërtitë e anës së jashtme të njeriut si dhe t'i kushtojmë rëndësi të veçantë pastrimit të zemrës nga veset e këqija, në mënyrë që të jemi në gjendje të komunikojmë me Krijuesin e kësaj gjithësie.

⁵² El-Maideh (5), ajeti 6.

17. Rregullat ushqimore

XVII. RREGULLAT USHQIMORE

Ajo që më ka joshur nga Kurani qysh nga ditët e para, është se sa herë që Allahu urdhëron me ndonjë nga urdhëresat e Tij, gjithmonë na shpjegon edhe arsyet e ajetit. Me të vërtetë që jemi qenie njerëzore inteligjente. Pothuajse secili nga ne e di se mishi i derrit është i ndaluar, mirëpo përveç këtij lloji të ushqimit, hasim edhe në shumë ushqime të tjera të ndaluara:

Allahu xh.sh. thotë:

وَلَا تَأْكُلُوا مِمَّا لَمْ يُذَكَّرِ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ وَإِنَّهُ لَفِسْقٌ وَإِنَّ
الشَّيْطَانَ لِيُوحِيَ إِلَىٰ أَوْلِيَآئِهِمْ لِيُجْنِدُوا لَكُمْ وَإِنَّ
أَطَعْتُمُوهُمْ إِنَّكُمْ لَمُشْرِكُونَ ﴿١٢١﴾

“Dhe mos hani nga ajo, (para therjes së të cilës) nuk është përmendur emri i Allahut, vërtet ajo (ngrënie) është gjynah. Djajtë i nxisin miqtë e tyre që t’ju polemizojnë, e nëse i dëgjoni, bëheni si ata (idhujtarë).”⁵³

Po ashtu edhe në ajetin vijues i Plotfuqishmi thotë:

⁵³ El-En’am (6), ajeti 121.

قُلْ لَا أَجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعَمُهُ إِلَّا أَنْ
يَكُونَ مَيْتَةً أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ لَحْمَ خِنزِيرٍ فَإِنَّهُ رِجْسٌ أَوْ
فِسْقًا أَهْلًا لِيُغَيِّرَ اللَّهُ بِهِ ۚ فَمَنْ اضْطُرَّ غَيْرَ بَاغٍ وَلَا عَادٍ فَإِنَّ
رَبَّكَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٤٥﴾

“Thuaj: ‘Në atë që më është shpallur (në Kuran) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri - është i ndytë, dhe përveç asaj që është therrur jo në emër të Allahut (por të ndonjë idhulli) e që është gjynah. E kush detyrohet (t’i hajë këto), por duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, Zoti yt falë e mëshiron shumë.’”⁵⁴

Nga ky ajet dhe ajete të tjera, shohim se Allahu xh. sh. na e ka ndaluar të ushqyerit me këto lloje ushqimesh: cofëtinën, çdo gjë që vdes vetiu, gjakun e derdhur, mishin e derrit, për arsye se konsiderohet neveri dhe e papëlqyer, po ashtu mishi i therur për hir të idhujve si dhe mishi i kafshës së therur pa u përmendur emri i Allahut të Madhërishëm.⁵⁵ Mirëpo, sërish në fund të ajetit shohim se Allahu na e bën me dije që nëse hamë diçka nga ushqimet e lartpërmendura pa pasur njohuri mbi dispozitat dhe duke mos pasur për qëllim shijen, pa dyshim se Allahu do të na e falë, si rrjedhojë

⁵⁴ El-En’am (6), ajeti 145.

⁵⁵ The Holy Qur’an, English Translation of the Meanings and Commentary, f. 278.

mund të themi se qëllimi i ajetit përsëri është bërë i qartë dhe i ditur për mbarë njerëzimin.

Nga ushqimet që cekëm më lart, kurrë nuk duhet ngrënë asgjë, ngase nuk janë të dobishme për shëndetin, dhe së këndejmi jemi të porositur që t'i bindemi urdhërit të Krijuesit, e gjithë kjo është në favor të shpirtave tanë! Në vazhdim, Allahu i Plotfuqishëm, kur flet mbi çështjen e teprimit dhe shpërdorimit të ushqimit, na e tërheq vërejtjen duke thënë:

قَدْ خَسِرَ الَّذِينَ قَتَلُوا أَوْلَادَهُمْ سَفَهًا بِغَيْرِ عِلْمٍ وَحَرَّمُوا مَا رَزَقَهُمُ
 اللَّهُ افْتِرَاءً عَلَى اللَّهِ قَدْ ضَلُّوا وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ ﴿١٧٤﴾ وَهُوَ
 الَّذِي أَنْشَأَ جَنَّاتٍ مَعْرُوشَاتٍ وَغَيْرِ مَعْرُوشَاتٍ وَالنَّخْلَ وَالزَّرْعَ
 مُخْتَلِفًا أَكْلُهُمُ وَالزَّيْتُونَ وَالرُّمَانَ مُتَشَابِهًا وَغَيْرَ مُتَشَابِهٍ
 كُلُوا مِنْ ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ وَآتُوا حَقَّهُ يَوْمَ حَصَادِهِ وَلَا
 تُسْرِفُوا إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ ﴿١٧٥﴾

“S’ka dyshim se kanë dështuar ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjelehtësia e pa kurrfarë dije, dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim. Ai është që krijoi kopshte (bimët e të cilave) të ngritura lart (në shtylla) dhe të rrafshata (të shtrira në tokë), edhe hurmat dhe dritërat me fryte (shije) të ndryshme; (krijoi) ullinjte dhe shegët e ngjashme (nga forma) e jo të ngjashme (nga shija). Hani frutat e tyre kur të piqen dhe ditën e vjeljes

së frutave jepeni atë pjesë që është obligim (të varfërve e nevojtarëve) dhe mos teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit.”⁵⁶

Si shkak i kryerjes së shumë gjynaheve e krimeve është edhe mosnjohja e të mirës dhe të keqes, të drejtës dhe të padrejtës, kur njerëzit nuk janë në gjendje të dallojnë midis këtyre dy çështjeve, pa dyshim se ata janë në gjendje të kryejnë të gjitha llojet e gjynaheve, të përfshihen edhe në kryerjen e krimeve, madje mund të vrasin edhe fëmijët e tyre; të ndalojnë edhe atë që Allahu e ka bërë të lejuar për ne.

Është shumë pikëlluese kur hasim në këtë kategori njerëzish. Vetëm Allahu është Ai që dhuron të gjitha llojet e ushqimeve për krijesat e Tij. Këtë mund ta vërtetojmë nga ajeti i sapopërmendur; njëherazi jemi të porositur që një pjesë t’ua dhurojmë të varfërve e nevojtarëve. Mirëpo, mos të harrojmë se shpërdorimi i ushqimit është i ndaluar, pasi ka shumë njerëz të varfër dhe po qe se nuk mendojmë rreth hallit të tyre, do të tregohemi shumë egoistë.

Mësimi i fundit që mund të nxjerrim nga ky ajet është edhe ky: Allahu xh.sh. nuk i do ata që e teprojnë dhe që e shpërdorin ushqimin e tyre, duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe normat islame. Do të ishte mirë sikur këtë mësim ta kujtonim përherë.

⁵⁶ El-En’am (6), ajetet 140-141.

18. Namazi

XVIII. NAMAZI

Njeriu gjatë namazit komunikon me Krijuesin, mirëpo nëse pyesni se si ta përkufizoj nocionin ‘namaz’ apo ‘të falurit’, do të kisha thënë se namazi është ushqim për shpirtin. Kur posedojmë një ushqim të mirë, një vakt ushqimi të harmonizuar, padyshim se ndihemi të ngopur e të qetësuar, përderisa gjatë faljes ndihemi të lumtur e të kënaqur. Prandaj prej nesh kërkohet që shpirtin ta ushqejmë pesë herë në ditë. Namazin tonë e fillojmë me lutjen, duanë dhe suren më të bukur ndër të gjitha e ajo është kaptina hyrëse, më saktësisht e njohur nga të gjithë ne me emrin Sure el-Fatiha:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾
الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٣﴾ مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٤﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ
وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾ أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾ صِرَاطَ
الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

“Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botërave! Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Sunduesit të Ditës së Gjykimit! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë! Na udhëzo në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, që i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër vetes

tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”⁵⁷

Sikur ta rroknim kuptimin e thellë të kësaj kaptine kuranore dhe ta zbatonim në jetën tonë, nuk do të kishim pasur nevojë për diç më shumë. Gjithashtu, para lindjes së diellit jemi të porositur që doemos të kryejmë faljen e mëngjesit. Është pak e rëndë të zgjohemi nga gjumi në këtë kohë, mirëpo prapë jemi të obliguar që ta kryejmë këtë obligim. Sido që të jetë, në çastin kur e braktisim të gjumin tonë të dashur që të falemi, atëherë e kemi kuptuar rëndësinë e namazit.

Gjatë kësaj kohe, mendjet tona janë të pastërta dhe të kthjellta nga të gjitha gjërat materiale të kësaj bote dhe për këtë gjë namazi do të dëshmojë. Duhet cekur se gjatë kryerjes së namazit të mëngjesit, kemi një lutje shumë të veçantë, të cilën duhet ta shqiptojmë patjetër gjatë namazit:

الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا إِنَّنَا أَمْنَا فَأَعْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَقِنَا عَذَابَ

النَّارِ

“Ata të cilët thonë: ‘Zoti ynë, ne besuam me sinqeritet, na i fal gjynahet tona dhe na ruaj prej ndëshkimit të zjarrit!’”⁵⁸

Më pas vazhdojmë me namazin e mesditës, pastaj me namazin e pasdites, namazin e muzgut dhe më vonë me namazin e mbrëmjes. Duhet ta kemi parasysh se gjatë kryerjes së këtyre namazeve, duhet treguar sinqertet.

⁵⁷ El-Fatiha (1), ajetet 1-7.

⁵⁸ Ali Imran (3), ajeti 16.

Sikur të ishim në gjendje të jemi të sinqertë si fëmijët, do të ishim kthyer te Zoti në të njëjtën gjendje në të cilën na lindi nëna: të pastër dhe të sinqertë, pa asnjë gjynah.

قُلْ أَمَرَ رَبِّي بِالْقِسْطِ وَأَقِيمُوا وُجُوهَكُمْ عِندَ كُلِّ مَسْجِدٍ
وَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ كَمَا بَدَأَكُمْ تَعُودُونَ ﴿٧٩﴾

“Thuaj: ‘Allahu më urdhëroi drejtësinë dhe kthejuni Atij në tërësi në çdo namaz dhe adhurojeni duke qenë të sinqertë në lutje vetëm për Të. Ashtu siç ju krijoi në fillim, po ashtu do të ktheheni te Ai.’”⁵⁹

Në të vërtetë, ne kemi një perceptim të gabuar mbi termin sukses, të cilin shumica e njerëzve e lidhin me paratë, karrierën apo familjen e madhe. Sidoqoftë, sukcesi i vërtetë është që të jesh besimtar i drejtë, i vazhdueshëm në kryerjen e namazeve dhe nënkupton nënshtrimin e përlulesinë, ngase vetëm besimtarët do të hyjnë në parajsë:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ﴿١﴾ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ ﴿٢﴾

“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: Ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit.”⁶⁰

Po ashtu edhe në ajetet vijuese, Allahu xh.sh. thotë:

⁵⁹ El-A'raf (7), ajeti 29.

⁶⁰ El-Mu'minun (23), ajetet 1-2.

وَالَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ ﴿٩﴾ أُولَٰئِكَ هُمُ الْوَارِثُونَ ﴿١٠﴾
 الَّذِينَ يَرِثُونَ الْفِرْدَوْسَ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿١١﴾

“Dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdeusin dhe aty do të jenë përgjithmonë.”⁶¹

Në Kuranin Famëlartë ka mjaft sure të bukura, ne mund të zgjedhim atë që e duam më së shumti për nevojat tona, për vlerat tona dhe për moshën. Lutjen të cilën më së shumti e parapëlqej gjatë jetës sime është:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٢٧﴾
 لَا شَرِيكَ لَهُ ۗ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمَسْلُومِينَ ﴿١٢٨﴾

“Thuaj: ‘Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botërave. Ai nuk ka shok. Me këtë jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve!’”⁶²

Përmendja e Allahut xh.sh. gjatë kryerjes së namazit sjell një ndjenjë dhe emocion të paqes dhe qetësisë, e cila pastaj e mbështjell edhe zemrën. Ja se ç’thotë Allahu në vazhdim:

⁶¹ El-Mu’minun (23), ajetet 9-11.

⁶² El-En’am (6), ajetet 162-163.

أَتْلُ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ ۖ إِنَّ الصَّلَاةَ
تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ ۗ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ ۗ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا

تَصْنَعُونَ ﴿٤٥﴾

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kurani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të këqijat, e përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve); Allahu e di se ç’punoni.”⁶³

Gjatë ditës kemi aktivitete të ndryshme në kohë të ndryshme dhe, ndër to doemos duhet patur në konsideratë prania e të Madhit Allah. Duke përmendur Allahun vazhdimisht, zgjedhjet tona drejt rrugës së drejtë do të përfundojnë dhe përmbushen më me lehtësi. Kur jemi në gjendje të keqe, mësohemi se si të kërkojmë ndihmën nga Allahu i Madhërishëm; kur jemi në pozitë të mirë dhe ndihemi të qetë, mësohemi se si ta falënderojmë Atë.

Ne jemi ata që kemi nevojë për t’u falur e për të kërkuar ndihmë, Allahu xh.sh. nuk ka nevojë për askënd; këtë duhet ta mbajmë mend çdo herë, prandaj një gjë e tillë do të na mësojë se si të jemi në kontakt me të vërtetën. E vërteta dhe realiteti është Allahu, Krijuesi ynë.

⁶³ El-Ankebut (29), ajeti 45.

19. Lēmosha (sadaqaja)

XIX. LËMOSHA (SADAKAJA)

Lëmosha shpaloset nga dora në dorë, bashkë me të falurit (namazin). Ndërmjet shpirtërores (shpirtit) e materiales (trupit), ekziston një lum i vazhdueshëm. Po ashtu, këtë dukuri e gjejmë edhe mes fjalëve dhe veprave. Përmes namazit arrijmë të komunikojmë me Krijuesin e gjithësisë, mirëpo duke dhënë lëmoshë, këto fjalë dhe lutje të cilat i këndojmë gjatë namazit, automatikisht shndërrohen në vepra. Si është e mundur që të falim namaz, të kërkojmë falje nga Allahu, përderisa fqiu ynë nuk ka as bukë për të ngrënë? Si mund të kërkojmë nga Zoti që të na shpërblejë me Xhennet, përderisa i afërmi ynë vuan nga sëmundja dhe ne nuk i ofrojmë ndihmë fare? Në botën e ardhshme nuk do të na ndihmojnë vetëm fjalët, por ajo që do të na ndihmojë janë veprat dhe fjalët e mira së bashku me ndihmën e Allahut. Kujt duhet t'i jepet lëmoshë?

يَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنْفِقُونَ ۗ قُلْ مَا أُنْفِقْتُمْ مِنْ خَيْرٍ فَلِلْوَالِدَيْنِ
وَالْأَقْرَبِينَ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ ۗ وَمَا تَفْعَلُوا مِنْ خَيْرٍ
فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ ﴿٩٥﴾

“Të pyesin se ç’do të japin. Thuaj: ‘Atë që jepni prej pasurisë jepenit për prindërit, për të afërmit, për jetimët,

*për të varfërit, për udhëtarët. E çdo të mirë që punoni,
s'ka dyshim se Allahu e di.”⁶⁴*

Sikur çdo njeri të jepte lëmoshë duke ndihmuar së pari prindërit, pastaj të afërmit, jetimët, udhëtarët etj., nuk do të shihnim asnjë të varfër në këtë botë. Vlen të ceket se gjatë dhënies së lëmoshës, duhet të jemi të sigurtë se qëllimi i dhënies së lëmoshës bëhet vetëm për hir të Allahut dhe nuk duhet të kërkojmë asnjë shpërblim, madje as falënderim nga pranuesi i saj.

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

وَيُطْعِمُونَ الطَّعَامَ عَلَىٰ حُبِّهِ مِسْكِينًا وَيَتِيمًا وَأَسِيرًا ﴿٢٥﴾ إِنَّمَا
نُطْعِمُكُمْ لَوَجْهِ اللَّهِ لَا نُرِيدُ مِنْكُمْ جَزَاءً وَلَا شُكْرًا ﴿٢٦﴾

*“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve,
jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm
për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë as shpër-
blim e as falënderim.”⁶⁵*

Kjo është më e lehtë të thuhet, sesa të bëhet, por me të filluar ta zbatojmë do të shohim se bëhemi njerëz më të mirë dhe nuk do të zhgënjehemi. Sepse zhgënjimet janë rezultat i pritshmërive tona! Në Kuran kemi një parabolë të mrekullueshme për ata që japin për kënaqësinë e Zotit:

⁶⁴ El-Bekare (2), ajeti 215.

⁶⁵ El-Insan (76), ajeti 8-9.

وَمَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمُ ابْتِغَاءَ مَرْضَاتِ اللَّهِ وَتَثْبِيتًا مِّنْ
 أَنفُسِهِمْ كَمَثَلِ جَنَّةٍ بِرَبْوَةٍ أَصَابَهَا وَابِلٌ فَاتَتْ أُكُلَهَا
 ضِعْفَيْنِ فَإِن لَّمْ يُصِبْهَا وَابِلٌ فَطُلٌّ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ

“E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fruta të dyfishtë. Po edhe nëse nuk i bie shi i madh, i bie një rigë. Allahu sheh atë që veproni.”⁶⁶

Është më rëndësi që të kuptohet nocioni lëmoshë. Të gjithë duhet të japim lëmoshë, duke u bazuar në qëllimet tona. Në fakt, nëse dëshirojmë që përmes lëmoshës të arrijmë devotshmëri, atëherë duhet mësuar edhe se si të japim lëmoshë:

لَن تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ ۚ وَمَا تُنْفِقُوا مِن شَيْءٍ
 فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ ﴿٩٢﴾

“Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë me besim derisa të mos e jepni më të dhimbshmen e pasurisë suaj. Çfarëdo që të jepni, Allahu e di atë.”⁶⁷

Nga ky varg kuranor, mësojmë se doemos duhet të japim prej gjërave më të dashura që zotërojmë, pra të japim më të dhimbshmen e pasurisë sonë. Fundja, është shumë e lehtë të japim diçka që s’e pëlqejmë, apo diçka që s’na hyn në punë. Vështirësia qëndron në dhënien e

⁶⁶ El-Bekare (2), ajeti 265.

⁶⁷ Ali Imran (3), ajeti 92.

asaj që e duam më shumë nga pasuria jonë. Ka njerëz të cilët paranë e dashurojnë tej mase, të tjerët dashurojnë veten deri në atë shkallë sa që për ta asgjë nuk luan rol, ajo që atyre u intereson është të kënaqin epshin e tyre.

Të jesh i aftë të japësh është mjaft me rëndësi, sepse arritja e devotshmërisë është një synim për të cilin të gjithë duhet të garojmë, pasi ajo konsiderohet burim i urtësisë dhe urtësia është burim i lumturisë.

20. Shëndeti

XX. SHËNDETI

Të gëzosh shëndet të mirë është një begati e dhuruar nga Zoti. Kur ndihemi mirë fizikisht, jemi në gjendje të kryejmë shumë punë, ndërsa të vuash nga sëmundjet përbën vërtetë problem dhe telash. Çfarë na këshillon Allahu në Librin e Tij lidhur me sëmundjen? Ibrahim i alejhisselam kuptoi një fakt shumë thelbësor. Kur u sëmur Ibrahim i alejhisselam, Allahu xh.sh. ishte Ai që e shëroi, prandaj duhet që me çdo mënyrë të kërkojmë ndihmë nga Zoti i Madhërishëm. Në vazhdim Allahu xh.sh. përsëri na njofton, duke thënë:

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ أَنِ اتَّخِذِي مِنَ الْجِبَالِ بُيُوتًا وَمِنَ الشَّجَرِ
وَمِمَّا يَعْرِشُونَ ﴿٦٧﴾ ثُمَّ كُلِي مِن كُلِّ الثَّمَرَاتِ فَاسْلُكِي سُبُلَ رَبِّكِ
ذُلًّا تَخْرُجُ مِنْ بُطُونِهَا شَرَابٌ مُّخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ فِيهِ شِفَاءٌ لِلنَّاسِ
إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٦٨﴾

“Zoti yt i dha instinkt bletës: ‘Ndërto shtëpi nëpër kodra, nëpër drunj dhe nëpër kulmet që ata (njerëzit) i ndërtojnë. Pastaj ha nga të gjitha frutat dhe futu nëpër rrugët e nënshtruara prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka

shërim (bar-ilaç) për njerëz. Edhe në këtë ka argument për atë popull që mendon thellë.”⁶⁸

Ajetet e lartpërmendura na bëjnë me dije se nga mjalti ka shërim. Lëngu me ngjyra të ndryshme formon mjaltin, në të cilin ka bar shërimi për njerëzit. Lëngu në fjalë del nga kosheret e bletëve, ku në të njëjtën kohë i ndryshon edhe ngjyra, në varësi të larmisë së luleve që bletët i vizitojnë për të mbledhur polenin. Le ta analizojmë këtë dukuri dhe të orvatemi të kuptojmë shkaku që fshihet pas saj: përse mjalti është i mirë dhe shërues? Nga rezultatet e arritura prej mjekëve gjatë humltimeve të tyre, po japim disa prej tyre:

Mjekësia moderne prirët të mbështetet tek antibiotikët në kurimin e sëmundjeve, të cilat kanë arritur gjendje akute. Por duket më e logjikshme që të shmangët infeksioni ose më e pakta të ndalet në fazat fillestare. Kurimi mund të arrihet nga forcimi i aftësisë së vetë trupit për të luftuar infeksionin, para se ky të gjejë pakëmbështetje të rëndësishme. Ushqimi i mirë dhe qëndrueshmëria emocionale janë faktorë të rëndësishëm jetikë, që ndikojnë në mbrojtjen e trupit. Mjalti mund të jetë një tjetër mbrojtës.

Meqenëse ai përmban sasira të vogla përbërësish antibiotikë, të pidentifikuar deri tani, një marrje ditore e një sasive të caktuar mjalti, do të siguronte në sfond një nivel të konsiderueshëm të kësaj lënde, e cila do ta ndihmonte trupin të luftonte infeksionin. Ka prova të konsiderueshme se, ata njerëz që marrin mjaltë të freskët si pjesë të dietës ditore, janë më të shëndetshëm se të

⁶⁸ En-Nahl (16), ajeti 68-69.

tjerët që nuk e bëjnë këtë. Në fakt nuk ka ndonjë mjekim popullor të veçantë, që të jetë bashkëshoqërues më i madh se mjalti.

Studimi i bletëve, ka qenë tema e shumë shkrimeve të studiuesve të mjekësisë, që nga kohët e lashta. Sigurisht, nëse dikush lexon rreth lashtësisë do të zbulojë se, vetëm pak prej sëmundjeve nuk kuroheshin nga mjalti ose disa produkte të tjera të bletës. A mund ta shpërfillim bashkëshoqërimin e madh historik ndërmjet mjaltit e shëndetit?⁶⁹

Këto janë studimet dhe arritjet e mjekëve, mirëpo le të thellohemi për një çast. Të nisemi nga pikëpamja se çdo gjë e cekur nga Allahu në Kuran është e vërtetë dhe nuk ka pikë dyshimi, prandaj jemi të informuar se aty ka edhe shërim për njerëzimin. Pra, a ka mundësi që vetëm një produkt natyror të shërojë? Besoj se përgjigja është shumë e thjeshtë. Ajo na ruan sistemin e imunitetit në gjendje të mrekullueshme. AIDS-i na shkatërron shëndetin dhe imunitetin, prandaj dhe çdo lloj sëmundjeje dhe virusesh e sulmojnë. I vetmi kundërhelm ndaj tij është mjalti. Duke patur sistem të mirë imunitar, jemi në gjendje ta largojmë sëmundjen, kështu që është mirë që çdo ditë të hamë dy lugë mjalt. Të nderuar lexues, në asnjë rast nuk duhet harruar se Allahu i Madhërishëm është Ai që na krijoi, di çfarë ne nuk dimë, ndaj është më mirë që gjithmonë t'i ndjekim këshillat dhe porositë e të Madhit Zot.

Tani po e shikojmë shëndetin nga një perspektivë tjetër. Përderisa mjalti kujdeset për anën materiale të trupit, në asnjë mënyrë nuk duhet harruar rëndësia e

⁶⁹ *Honey and Health* (Mjalti dhe shëndeti), Croft, f. 94.

emocioneve, siç e pamë nga paragrafi i mësipërm, ku spikatet se stabiliteti emocional është faktor i rëndësishëm jetik. Kurani i kushton vëmendje edhe stabilitetit emocional, saqë kur ta ushtrojmë, ndihemi të gëzuar, të lumtur, të hareshëm, çfarë tregon qëndrueshmërinë dhe rehatinë emocionale.

Jeta ka shumë telashe, por pavarësisht prej tyre, kur ta shquajmë të drejtën nga e padrejta, të mirën nga e keqja, vetëm atëherë do të jemi të aftë të veprojmë në mënyrë të duhur, si në fatkeqësi ashtu edhe në gëzim. Infarkti i zemrës mund të na jetë përkujtues se jeta nuk është përgjithmonë. Çfarë ndodh pas infarktit në zemër?

Sipas një studimi, pacientët me depresione kronike të zemrës ka gjasa të vuajnë nga infarkti i dytë në të njëjtin vit. Depresioni afatshkurtër është i zakonshëm pas infarktit në zemër. Të rejat e fundit tregojnë që nëse depresioni nuk ndalon dhe pacienti nuk ka mbështetje nga familja, shokët apo psikiatri, kjo do të thotë se infarkti i dytë i zemrës është më se i mundshëm. Studiimi është botuar në të përmuajshmen e Shoqatës Amerikane për çështjet e zemrës dhe ishte kryer në 887 persona. Thuajse një e treta kishte raportuar se depresioni ishte i vazhdueshëm pas infarkteve të tyre të zemrës.⁷⁰

Nëse personi ndien qetësi në zemër, ai nuk përballet me depresionin. Ç'është e vërteta, njeriu mund të hasë në shumë gjëra, pasi është i ndërgjegjshëm se i përket Zotit! Allahu i Madhërishëm thotë në Kuran:

⁷⁰ *The New York Times*, 26 April, 2000.

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَتْكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي

الْصُّدُورِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٧﴾

“O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj, udhëzim e mëshirë për besimtarët.”⁷¹

Në këtë ajet, Kurani shumë bukur nxjerr në pah sëmundjet emocionale. Nga krejt ajo që u tha shohim se të dy entitetet - materiale dhe shpirtërore - merren parasysh.

⁷¹ Junus (10), ajeti 57.

21. Familija

XXI. FAMILJA

Fokusimi ndaj familjes është obligim i përditshmërisë sonë. Sa herë që t'i hapim sytë do të shohim se gjendemi në mes të familjes. Shohim prindërit duke u kujdesur për ne: nëna kujdeset për nevojat tona imediate, babai për financën e kështu me radhë. Në të shumtën e rasteve ne s'i vërejmë këto, vetëm kur të plakemi fillojmë t'i kuptojmë, atëherë kur të shohim më shumë rreth gjërave e objekteve që na rrethojnë. Pyetjet e shumta fillojnë nga mosha gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Gjatë kësaj moshe, prindërit i shikojmë nga një këndvështrim tjetër dhe vetëm kur të fillojmë t'i kuptojmë sendet përreth, shohim se në fund të fundit ata nuk janë njerëz pa të meta, që dikur i mendonim si të tillë.

Sido që të jetë, në familje gjithmonë mbretëron një lidhje e veçantë dhe e fortë, kështu që ata prapëseprapë i kemi prindër. Ndonëse nuk janë të përkryer, prapëseprapë ata na duan dhe kështu edhe ne i duam. Pra, ekziston diçka speciale që është lidhja e dashurisë mes prindërve dhe fëmijëve. Siç duket, së fundmi kemi filluar ta humbim disi këtë lidhje të dashurisë. Shumë fëmijë të porsalindur janë të braktisur nëpër rrugë, kanale, spitale apo i gjejmë të vdekur pas një kohe shumë të gjatë. Gjithashtu, shohim djem e vajza të reja duke konsumuar drogë, duke u sjellë në mënyrë të pamoralshme etj. Të gjitha këto vepra vijnë si rezultat i braktisjes së rrugës së drejtë dhe i pasimit të rrugës së keqe, rrugës së

djallit. Synimi i burrit dhe i gruas në këtë jetë është karriera, prandaj që të dy dalin për ta arritur këtë karrierë. Në fakt, gratë në përgjithësi janë duke marrë shumë profesione të meshkujve, ndërsa burri ka një problem të madh, pasi për gratë të përshtaturit e punëve të meshkujve është i mundshëm, mirëpo kurrsesi e anasjellta, pra është e pamundur që burri të arrijë atë që e arrin gruaja.

Ja kështu është realiteti; vetëm gratë mund të mbesin shtatzëna dhe të jenë të lumtura kur të lindin fëmijë. Në këtë zhvillim, shohim se gruaja ka harruar apo më mirë të themi, është duke harruar se qëllimi i lindjes së saj ishte që ajo të lindë fëmijë, të kujdeset për familjen e saj, të qëndrojë pranë fëmijëve, që kur t'i kërkojnë ndihmë, ajo t'u dalë në ndihmë. Roli i saj është ai i dashurisë, prandaj është shumë e vështirë t'i themi fëmijës që i është dhuruar çdo komoditet, rehati e një varg shërbëtorësh: Nëna të do shumë. Fëmija do të habitet nga kjo thënie, si është e mundur që nëna ta shqiptojë këtë fjali, kur ajo nuk qëndron aspak me fëmijën? Kur dashurojmë dikë, për të edhe flijojmë diçka nga jeta jonë, një pjesë të jetës dhe të gjymtyrëve tona ua kushtojmë atyre që i duam. Familja është gjëja më e shtrenjtë në jetën tonë. Cili është roli dhe pozita që Kurani ia ka dhuruar burrit dhe gruas?

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى
بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ فَالصَّالِحَاتُ قَنِينَاتٌ حَافِظَاتٌ
لِّلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ وَالَّتِي تَخَافُونَ نُشُوزَهُنَّ فَعِظُوهُنَّ

وَأَهْجُرُوهُنَّ فِي الْمَضَاجِعِ وَاضْرِبُوهُنَّ فَإِنْ أَطَعْتَكُمْ فَلَا تَبْغُوا

عَلَيْهِنَّ سَبِيلًا إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا كَبِيرًا ﴿١٤﴾

“Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase Allahu ka graduar disa mbi disa të tjerë dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre. Prandaj, me atë që Allahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë respektuese, besnike ndaj të fshehtës. E atyre që ua keni frikën për kryelartësi, në fillim këshillojini, pastaj largohuni nga shtrati (e më në fund) i rrihni (lehtë) e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. Allahu është më i Larti, më i Madhi.”⁷²

Roli i burrit është që ta mbrojë dhe ndihmojë familjen e tij, ndërsa gruaja të kujdeset për familjen. Gjatë këtij bashkëpunimi shpirtëror, kemi një ndërthurje të përkryer për një familje të përsosur. Pas kësaj, në vazhden e jetës, ballafaqohemi me një mister të mrekullueshëm, i cili është i shpjeguar: ajo fshehtësi është “dashuria.”

Si është e mundur që të martohemi me një person që nuk e dashurojmë? Si mund të lindim fëmijë pa prarinë e dashurisë? Dashuria në fakt është një nga shenjat e Allahut. Nëse dy persona martohen pasi duhen me të vërtetë, pa dyshim se shumë të meta do të evitohen, mirëpo nëse në këtë martesë nuk frymon dashuria, atëherë çdo e metë do të jetë pengesë drejt ndërtimit të marrëdhënieve të mira dhe lidhjeve familjare. Pa dyshim, dashuria është parim bazë i një martese të shëndoshë dhe të mirë.

⁷² En-Nisa (4), ajeti 34.

Allahu i Gjithmëshirshëm thotë:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا
وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ

يَتَفَكَّرُونَ ﴿٣٠﴾

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”⁷³

Cili është roli i muslimanes si nënë?

وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنَ كَامِلَيْنَ... ﴿٣١﴾

“Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjidhënien, janë të obliguara t’u japin gjë fëmijëve të vet dy vjet të plota...”⁷⁴

Do të kisha pasur dëshirë që të tërheq vëmendjen e lexuesit, kur është fjala rreth gjidhënies dhe përkujdesjes ndaj foshnjës. Në fakt, si nëna jemi të porositura që periudha e gjidhënies dhe e kujdesit për foshnjën duhet të numërojë tridhjetë muaj, këtu kam për qëllim shtatzëninë, gjidhënien dhe kujdesjen ndaj fëmijës, kjo është vërtetë një çështje me rëndësi të cilës duhet t’i kushtojmë rëndësi. Për këtë kemi edhe porosinë kuranore:

⁷³ Err-Rrum (30), ajeti 21.

⁷⁴ El-Bekare (2), ajeti 233.

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ
 كُرْهًا وَحَمَلُهُ وَفِصْلُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُ وَبَلَغَ
 أَرْبَعِينَ سَنَةً قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ
 وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي إِنِّي
 تُبِّتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿١٥﴾

“Ne e urdhëruam njeriun që t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet e mbarti me mundim dhe e lindi me vështirësi, e bartja e tij dhe gjdhënia i zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa të arrijë pjekurinë e kur t’i mbushë dyzet vjet thotë: ‘Zoti im, më frymëzo që të Të falënderoj për të mirën që më dhurove mua e prindërve të mij, që të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen dhe m’i bëj të mirë pasardhësit; unë pendohem te Ti dhe jam prej muslimanëve.”⁷⁵

Pas kësaj periudhe, shohim se fëmija ka krijuar lidhje shumë të fortë me nënën; edhe nëse shkon në çerdhe, ai do të kthehet te nëna duke qenë tejet i vetëdijshëm mbi pozitën e saj në jetën e tij. Pas arritjes së këtij suksesi, a mundet nëna të mendojë që të merret me një aktivitet tjetër apo me gjëra të tjera? Gjithmonë është e mundshme dhe e arritshme një gjë e tillë, ajo mund të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër, teksa fëmija është në çerdhe apo më vonë kur të vazhdojë mësimet.

⁷⁵ El-Ahkaf (46), ajeti 15.

Nga kjo që thamë nuk duhet kuptuar nënçmim i rolit të nënës e në asnjë mënyrë ulje e vlerës së gruas. Në fakt, kam parë shumë fëmijë me të meta që janë braktisur nga nënat e tyre që në lindje. Ata kanë një kërkesë të vazhdueshme drejt njohjes së shkaqeve dhe arsyeve përse janë braktisur nga nënat e tyre? Kjo ndjenjë e mospranimimit dhe e refuzimit të atyre me të meta, formon brenda tyre një ndjenjë lakmie dhe i bën të sillen në formë të palakmueshme. Shkaku përse veprojnë në këtë mënyrë është kërkimi i dashurisë së humbur që kurrë nuk do të gjendet. Ata mundohen që boshllëkun dhe zbrazëtirën e tyre ta mbushin me gjëra materiale a pronësi të skajshme, duke u shoqëruar me shumë njerëz dhe prapëseprapë shohim se kurrë nuk do t'u mjaftojnë.

Çfarë kuptojmë me shtëpinë ideale në një familje muslimane, duke u bazuar në mësimet kuranore? Babai shkon në punë, ndërsa nëna kujdeset për fëmijët kur janë të vegjël. Nuk është sakrificë të qëndrosh në shtëpi dhe të kujdesesh për fëmijët. Për gratë që thonë se kanë nevojë të kalojnë kohë edhe me veten e tyre apo nuk dëshirojnë të jenë të izoluara në shtëpi, apo siç thonë disa prej tyre se pas gjithë atyre viteve studim dhe arritje të gradës së fakultetit ndihen se po humbasin potencialin e tyre në shtëpi dhe nuk janë të gatshme për t'u bërë nënë. E njëjta gjë ndodh edhe me mashkullin që thotë se ka dëshirë të jetojë një jetë të mirë, të shëtisë gjatë ditës dhe natës dhe nuk është i gatshëm të formojë familje.

Të kesh familje është shumë me rëndësi, ku dy gjinitë janë të pjekur e të vetëdijshëm mbi përgjegjësitë e ndryshme, si lindja e fëmijëve. Kjo është edhe arsyeja se përse Kurani porosit që mashkulli doemos duhet të

paguajë dhuratën e martesës (mehr) dhe kurrsesi nuk duhet të martohet nëse nuk është në gjendje t’ia japë gruas këtë dhuratë. Disa njerëz të pakuptueshëm e marrin këtë sikur mashkulli paguan çmimin për gruan, kjo nuk është ashtu; në fakt, mashkulli duhet të jetë në gjendje ta ushqejë familjen në mënyrë që ta zotërojë atë. Nga kjo shohim përsëri balancën e bukur duke bashkërenditur jetën tonë sipas roleve që luajmë në familje e në shoqëri, pra si është e mundur të bëhemi shtetas të mirë kur nuk tregohemi prindër të mirë dhe të sjellshëm?

Jeta vazhdon dhe dalëngadalë fëmijët rriten e bëhen mjaft të pjekur që të fillojnë familjet e tyre. Tashmë roli i prindërve ndryshon, pasi që i kanë udhëzuar fëmijët e tyre në moshën madhore. Në këtë çast çdo gjë ndryshon, tani është koha kur fëmija duhet të luajë rolin e tij drejt prindërve. Është një rol i bamirësisë dhe i mirënjohjes:

وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ۚ إِمَّا يَبُلُغَنَّ
عِنْدَكَ الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أُفٍّ وَلَا
تَنْهَرَهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا ﴿٢٣﴾ وَأَخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ
الذُّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا ﴿٢٤﴾

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit dikë tjetër përveç Tij, dhe që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, por atyre thuaju fjalë të mira. Dhe në shenjë mëshire

shtrije pranë tyre krahun përlës e respektues dhe thuaj:
“Zoti im! Mëshiroji ata të dy, ashtu siç më edukuan
mua kur isha i vogël.”⁷⁶

Po ashtu edhe në kaptinën Lukman, Allahu xh.sh.
thotë:

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ وَهَنًا عَلَىٰ وَهْنٍ وَفَصَّلَهُ فِي

عَامَيْنِ أَنِ اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ إِلَىٰ الْمَصِيرِ ﴿١٤﴾

“Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj)
prindit, sepse nëna e vet e mbarti mund pas mudi dhe
pas dy viteve ia ndau gjinin. (E porositëm) Të jetë mi-
rënjohës ndaj Meje dhe prindërve të vet, sepse vetëm tek
Unë është kthimi juaj.”⁷⁷

Në të vërtetë ky është një urdhër që duhet ta zbatoj-
më së pari ndaj Krijuesit, duke qenë mirënjohës dhe fa-
lënderues ndaj Tij e më pas ndaj prindërve. Falënderimi
në këtë rast përfshin bamirësinë – si në fjalë, ashtu edhe
në vepra. Pasi që të kemi arritur këtë sukses, çdo gjë
është plotësuar me një ajet shumë të bukur kuranor, të
cilin duhet ta shqiptojmë në moshën dyzetvjeçare, duke
e falënderuar Allahun për të mirat që na ka dhuruar dhe
të kërkojmë nga Ai që fëmijët tanë t’i begatojë me
drejtësi e respekt. Allahu xh.sh. thotë:

⁷⁶ El-Isra (17), ajeti 23-24.

⁷⁷ Lukman (31), ajeti 14.

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ
 كُرْهًا وَحَمَلُهُ وَفِصْلُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُ وَبَلَغَ
 أَرْبَعِينَ سَنَةً قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ
 وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي إِنِّي
 تُتِّبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿١٥﴾

“Ne e urdhëruam njeriun që t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet e mbarti me mundim dhe e lindi me vështirësi, e mbartja dhe gjidhënia e tij zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa ta arrijë pjekurinë e vet dhe kur të mbushë dyzet vjet ai thotë: “Zoti im, më frymëzo mua që të Të falënderoj për të mirën që ma dhurove mua e prindërve të mij, që të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen dhe m’i bëj të mirë pasardhësit, unë pendohem te Ti dhe jam prej muslimanëve.”⁷⁸

Pasi të jetë kuptuar dhe shqiptuar kjo lutje kuranore, njeriu ka vënë në ekuilibër jetën e tij në përputhje me mësimet kuranore.

⁷⁸ El-Ahkaf (46), ajeti 15.

22. Përgjegjësia individuale

XXII. PËRGJEGJËSIA INDIVIDUALE

Shpeshherë mundohemi t'i justifikojmë gabimet dhe gjynahet duke u shfajësuar se jemi qenie njerëzore e si rrjedhojë konsiderohemi të gabueshëm apo nganjëherë kemi një demonstrim të mirë të të ashtuquajturës keqardhje ndaj vetes, duke arsyetuar se shkak i këtij veprimi apo i atij mëkati ishte lëndimi nga familja apo si rezultat se dikush na zemëroi dhe me këtë humbëm edhe barazpeshën e gjendjes shpirtërore e kështu me radhë. Pyetja që duhet të shtrojmë është se a jemi përgjegjës për veprat tona? A mund ta fajësojmë dikë tjetër për veprat tona të liga? Ta shohim çfarë thotë Kurani në lidhje me këtë:

كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ رَهِينَةٌ ﴿٧٤﴾

“Secili njeri është peng i veprës së vet.”⁷⁹

Duke u bazuar në ajetin kuranor, shohim se përgjegjësinë e mbartë vetë ai që e ka kryer e askush tjetër. Në rastin e kundërt, po qe se bazohemi në atë se çdo person i lindur në një familje të mirë, duhet të jetë i mirë dhe çdo person i lindur në një familje të keqe, duhet të rezultojë si i keq, këto janë koncepte frojdiste

⁷⁹ El-Muddeththir (74), ajeti 38.

dhe edipiane dhe pa dyshim se nëse besojmë në këto koncepte dhe paragjykime të gabuara, do të ikim nga përgjegjësia individuale. Kur ta kuptojmë se secili person është përgjegjës për veprat e tij dhe në Ditën e Gjyimit do të japë llogari para Krijuesit të tij për të gjitha veprat dhe punët e bëra në këtë botë, ajo është dita kur ne bëhemi drejtues në kabinën e jetës.

Mirëpo, le ta pranojmë si të tillë. Ne jemi qenie humane dhe si rrjedhojë, bëjmë gjynahe dhe jemi të gabueshëm. Prandaj, çfarë ndodh kur bëjmë gjynah? Ne pendo kemi tek Allahu sinqerisht e nuk i përsërisim, pasi Allahu është falës dhe fal. Ja se ç’thotë Krijuesi i këtij universi:

وَمَنْ يَعْمَلْ سُوءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُ، ثُمَّ يَسْتَغْفِرِ اللَّهَ يَجِدِ اللَّهَ
 غَفُورًا رَحِيمًا وَمَنْ يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُ عَلَى نَفْسِهِ ۗ
 وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا

“Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten, pastaj kërkon falje tek Allahu, e gjen Allahun falës dhe mëshirues. Kush bën ndonjë mëkat ka ngarkuar veten. Allahu i di hollësitë, është gjykatës i drejtë.”⁸⁰

Ç’është e vërteta, kur bëjmë gjynahe, vërejmë se ne jemi keqbërës. Me këtë kuptojmë edhe realitetin elementar që nëse veprojmë mirë, do të jemi përfitues të së mirës, por në qoftë se veprojmë keq, pa dyshim se pasojat e veprave të shëmtuara do t’i vuajmë ne, pasi

⁸⁰ En-Nisa (4), ajetet 110-111.

ato do të jenë kundër nesh. Allahu i Madhërishëm thotë në lidhje me këtë:

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا فَلِنَفْسِهِ ۖ وَمَنْ أَسَاءَ فَعَلَيْهَا ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ

تُرْجَعُونَ ﴿٥٤﴾

“Kush bën vepra të mira, bën për vete, e kush bën keq, bën kundër vetes, pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.”⁸¹

Pasi që të jetë thënë e vepruar çdo gjë, pavarësisht se na pëlqeu apo jo, e besojmë apo jo, përfundimi ynë do të jetë kthimi tek Allahu dhe në ditën e ringjalljes pjesët e trupit do të dëshmojnë kundër nesh, me fjalë të tjera, çdo organ i trupit tonë do të dëshmojë për veprat që ka kryer e nga kjo skenë njeriu do të habitet. Allahu i Plotfuqishëm, duke e përshkruar këtë, thotë:

الْيَوْمَ نَخْتِمُ عَلَىٰ أَفْوَاهِهِمْ وَتُكَلِّمُنَا أَيْدِيهِمْ وَتَشْهَدُ أَرْجُلُهُمْ بِمَا

كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿٥٥﴾

“Sot Ne ua mbyllim gojët atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan.”⁸²

Pas gjithë kësaj që mësuam nga ajetet e lartpërmendura, të mendojmë sërish mbi përgjegjësitë individuale që mbajmë mbi supe karshi Allahut, familjes, shoqërisë e vetes, sepse jemi përgjegjës para Zotit për veprat tona, para të afërmeve për mirëqenien e tyre materiale e

⁸¹ El-Xhathijeh (45), ajeti 15.

⁸² Jasin (36), ajeti 65.

shpirtërore, para shoqërisë për drejtësi dhe para vetes që të pastrojmë shpirtrat:

وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ﴿٧﴾ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ﴿٨﴾ قَدْ أَفْلَحَ

مَنْ زَكَّاهَا ﴿٩﴾ وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ﴿١٠﴾

“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten dhe ka dështuar ai që e poshtëroi atë.”⁸³

A mund ta imagjinojë ndokush një botë ku çdo individ do të ishte në gjendje ta kuptonte faktin bazë të së mirës dhe të së keqes? Në cilin vend ka qenie njerëzore që e kanë kuptuar përgjegjësinë e tyre drejt Krijuesit për çdo punë të bërë si dhe njohurinë që suksesin themelor ta gjejnë te pastrimi i shpirtit?

⁸³ Esh-shems (91), ajetet 7-10.

23. Frika

XXIII. FRIKA

Secili prej nesh ka frikë, e cila ndryshon varësisht nga aftësitë tona. Fjala vjen, nëse një grua e do bashkëshortin tej mase, ajo do të frikësohet se do ta humbasë. Nëse një person e çmon karrierën e tij apo të saj, ai ose ajo nuk do të jetë në gjendje të bëjë gjumë si duhet, e gjithë kjo vjen si rezultat i frikës se do ta humbë punën ose karrierën. Kur frikësohemi, bëhemi edhe më të dobët sepse nuk vetpërmbahemi nga emocionet. Nëse mbizotëron frika, atëherë çfarë lypset nga ne që të bëhemi më të fortë? Mënyra më e mirë për këtë do të ishte zëvendësimi i frikës negative me atë pozitive. Kur themi 'frikë negative', kemi për qëllim çdo frikë që lidhet qoftë me njeriun, siç është frika se po humbasim të dashurin apo frika ndaj sendeve e objekteve, fjala vjen se mos do të humbasim paratë, punën, karrierën etj. Kurse sa i përket 'frikës pozitive', kam për qëllim frikën ndaj Krijuesit të gjithësisë. Kur njeriu ia ka frikën Allahut, padyshim se sjellja e administrimi ynë do të jetë e denjë për çdo lëvdatë, pasi duke pasur në mendje frikën ndaj Allahut, jemi të vetëdijshëm 24 orë se Ai është duke na mbrojtur në çdo moment. Një gjë duhet ta kemi parasysh, kur kemi të bëjmë me frikën ndaj Allahut. Ajo s' duhet kuptuar si diçka tmerruese apo frikësuese. Në të kundërtën, ajo është e vërteta ngase me kuptimin e frikës ndaj Allahut, do të shohim se ajo na sjell më afër kuptimit dhe afrimit të Mëshirës së Tij. Prandaj,

me gjithë këtë do të themi: Vepro dhe sillu mirë nga dashuria e respekti për Krijuesin e Mëshirshëm i Cili na ka krijuar, vërtet ky lloj i frikës është i bukur e i ëmbël. Kjo i ngjan shembullit të një nëne të mrekullueshme prej së cilës dëshirojmë të dëgjojmë atë që kërkon ajo. Nga falënderimi dhe mirënjohja ndaj saj, veprojmë gjëra të mira për hir të saj. Kjo dashuri sjell edhe frikën se mos po bëjmë gjynah. Me të vërtetë Kurani flet rreth atyre që ia kanë frikën Allahut e të cilët janë në rrugën e drejtë:

إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسْجِدَ اللَّهِ مَن ءَامَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ
 الصَّلَاةَ وَءَاتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَخْشَ إِلَّا اللَّهَ فَعَسَىٰ أُولَٰئِكَ أَن
 يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ ﴿١٨﴾

“E drejta e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe Ditës së Fundit, që fal namazin, jep zekatin e nuk i frikësohet askujt tjetër përveç Allahut. Të tillët do të jenë të udhëzuarit”⁸⁴

إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَٰئِكَ هُم خَيْرُ الْبَرِيَّةِ ﴿١٩﴾
 جَزَاءُ هُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ
 فِيهَا أَبَدًا رَّضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَٰلِكَ لِمَنِ حُشِيَ رَبُّهُ

“Ndërsa, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, të tillët janë krijesa më e dobishme. Shpërblim për ta te Zoti i

⁸⁴ Et-Teubeh (9), ajeti 18.

tyre janë: vendet në xhennete nëpër të cilët burojnë lumenj, ku janë përgjithmonë, pa ndërprerje. Allahu është i kënaqur me ta e edhe ata janë të kënaqur prej Tij. E ky është për atë, që i ka pasur frikën Zotit të vet.”⁸⁵

Nga ajetet e mësipërme pamë se ky ishte grupi i njerëzve të cilët do të shpërblehen me Xhennete nga Allahu i Madhërishëm. Me të vërtetë, Ai ishte i kënaqur me ta dhe për këtë do të hyjnë në Xhennet. Ky ishte shembulli i bukur i miratimit të zëvendësimit të frikës negative me atë pozitive.

⁸⁵ El-Bejjineh (98), ajetet 7-8.

24. Fugjja dhe lumturia

XXIV. VUAJTJA DHE LUMTURIA

Jam rritur dhe edukuar me bindjen se çdo person duhet ta mbajë kryqin, kështu që nëse një grua është martuar me një burrë të cilit i pëlqen konsumimi i pijeve alkoolike, konsiderohej fat i keq për të; mu për këtë arsye nevojitej bartja e kryqit. Por a duhet të pranojmë vuajtjen si pjesë të jetës? A jemi lindur për të vuajtur? A mund ta gëzojmë lumturinë? Të gjitha këto pyetje sillen në mendjen tonë, mirëpo duke lexuar Kuranin dhe duke kuptuar domethënien e tij do të kuptojmë se nuk është aspak e nevojshme mbajtja e kryqit apo e gjërave të tjera.

Në fakt, lumturia është garanci për besimtarët. Megjithatë, për të arritur lumturinë, nevojitet edhe kuptimi i domethënies vuajtje. Cilat janë shkaqet që shpiejnë në vuajtje e cilat janë metodat efikase për ta mënjnuar atë në mënyrë që të bëjmë jetë të lumtur e të hareshme? Gjithsesi duhet ditur se vuajtja është dy llojesh:

1) Vuajtje e shkaktuar nga vetë njeriu: Ky lloj i vuajtjeve është si rezultat i punëve dhe i veprave tona të këqija. Allahu xh.sh., në lidhje me këtë lloj të vuajtjeve, thotë:

مَا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللَّهِ وَمَا أَصَابَكَ مِنْ سَيِّئَةٍ فَمِنَ

نَفْسِكَ وَأَرْسَلْنَاكَ لِلنَّاسِ رَسُولًا وَكَفَى بِاللَّهِ شَهِيدًا ﴿٧٩﴾

“Çfarëdo e mirë që të vijë është nga Allahu, e çfarëdo e keqe që të ndodhë është nga vetë ju. Ne të dërguam ty Pejgamber për mbarë botën. Mjafton që Allahu është dëshmues për këtë.”⁸⁶

مَنْ جَاءَ بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ خَيْرٌ مِّنْهَا وَمَنْ جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ فَلَا يُجْزَى

الَّذِينَ عَمِلُوا السَّيِّئَاتِ إِلَّا مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٨٠﴾

“Kush sjell me vete punë të mirë, atij do t’i takojë shpërblimi edhe më i madh, ndërsa ai që paraqitet me punë të këqija, do t’i jepet dënim vetëm aq sa e ka merituar.”⁸⁷

ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ لِيُذِيقَهُمْ

بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٨١﴾

“Për shkak të veprave (të liga) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza, për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga ligësitë).”⁸⁸

E mira vjen nga Allahu xh.sh., kurse e keqja vjen si rezultat i veprave tona të liga. Nuk është e mundur që

⁸⁶ En-Nisa (4), ajeti 79.

⁸⁷ El-Kasas (28), ajeti 84.

⁸⁸ Err-Rrum (30), ajeti 41.

Allahu xh.sh., i Cili është Krijuesi ynë, të dërgojë për ne gjëra të këqija. Më saktë do të thoja se ne jemi ata të cilët vetes ia sjellim gjëra të tilla duke zgjedhur rrugë të shtrembra, duke vepruar punë të shëmtuara etj. Ky është edhe shkaku se pse meritojmë të dënohemi; në fakt, dënimi është një mëshirë nga Allahu xh.sh. se vetëm në këtë mënyrë do të jemi në gjendje t'i korrigjojmë gabimet tona dhe t'i mënjanojmë rrugët e shtrembra, pra dënimi na qenka mëshirë nga Allahu xh.sh. duke na bërë me dije se kemi bërë gjynah. Si mund t'i kapërcejmë e t'i mposhtim vuajtjet që si personazh kryesor kanë vetë njeriun? Për t'i mundur vuajtjet dhe mundimet e tilla duhet të jemi në gjendje t'i pastrojmë zemrat nga të gjitha mendimet dhe qëllimet e këqija. Nga ne kërkohet që doemos ta pastrojmë veten nga punët që i bëjmë qëllimisht; jemi të informuar se mundësia për të bërë një gabim është më e lehtë, mirëpo për të do të mbajmë përgjegjësi, ndërsa Allahu nuk do t'i falë ata që veprojnë keq qëllimisht. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh. thotë:

لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَٰكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا كَسَبْتُمْ

قُلُوبِكُمْ ۗ وَاللَّهُ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿٢٢٥﴾

“Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por ju merr për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër. Allahu është i butë dhe falë shumë.”⁸⁹

Për çdo vepër tonën, duhet ta pyesim veten se ç'motiv dhe arsye fshihet pas saj. Nëse shohim se vërtetë

⁸⁹ El-Bekare (2), ajeti 225.

vepra që do bëjmë nuk ka motive të mira, atëherë me-
njëherë duhet të vendosim që të mos e kryejmë. Nuk
ka dyshim se një eksperiment i tillë kërkon punë, mirë-
po me ndihmën e Allahut mund të arrihet edhe sukcesi.
Vetëm atëherë kur ta pastrojmë veten tonë, do të jemi
në gjendje të jetojmë në paqe dhe nuk do të vuajmë
asnjëherë. Duhet ta dimë se çdo gjë që arrin lartë doe-
mos duhet të zbresë dhe në bazë të asaj që mbjellim
edhe do të korrim.

2) Periudha e sprovave: Gjatë kësaj periudhe, du-
het të mësojmë se si të bëhemi modest e të përlulur; të
qëndrojmë të durueshëm dhe të pathyeshëm në rastin e
fatkeqësive. Allahu xh.sh. thotë në ajetin vijues:

وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ
وَالْأَنْفُسِ وَالْثَّمَرَاتِ ۗ وَدَشِيرِ الصَّابِرِينَ ﴿١٥٥﴾ الَّذِينَ إِذَا أَصَابَتْهُمُ
مُصِيبَةٌ قَالُوا إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ ﴿١٥٦﴾ أُولَٰئِكَ عَلَيْهِمْ صَلَوَاتٌ
مِّن رَّبِّهِمْ وَرَحْمَةٌ ۖ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُهْتَدُونَ ﴿١٥٧﴾

*“Ne do t’ju sprovovimë me ndonjë frikë, uri, humbje
nga pasuria e nga jeta, si dhe nga frytet, po ti jepju
myzhe durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e
pakëndshme thonë: ‘të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai
do të kthehemi’! Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë be-
kime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në
rrugën e drejtë.”⁹⁰*

⁹⁰ El-Bekare (2), ajeti 155-157.

Gjithsesi do të sprovohemi me pasurinë që kemi; kjo është e vetmja mënyrë për të mësuar se në fund të fundit, vetëm Allahu është i Përkryer dhe vetëm atëherë do të jemi më të durueshëm, më të fortë. Sprovat e tilla do të na mësojnë të themi me zemër: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai kthehemi”! Si mund ta kapërcejmë periudhën e dytë, atë të sprovave?

Rreth moshës dyzet vjeçare, kemi të bëjmë me një periudhë testesh dhe sprovash të ndryshme. Në kuptimin e plotë të fjalës, jeta duket përtej kontrollit tonë. Çdo gjë që kemi në pronësi, do të testohet. Forca jonë do të ngarkohet deri në shkallën më të lartë. Është një periudhë e paracaktuar nëpër të cilën do të kalojë çdo njeri. E vetmja metodë për ta kapërcyer këtë fazë të sprovave është pajisja me besim të fortë në Allahun e Madhërishëm. Vetëm besimi mund të na mbajë në rrugën e drejtë. Është shumë e lehtë të veprojmë mirë, kur çdo gjë në rrugën tonë ecën mirë, mirëpo a do të jemi në gjendje ta mbajmë drejtësinë edhe atëherë kur çdo gjë është duke shkuar kundër nesh? A mund të hyjmë mes bamirësve edhe kur s’kemi para? A do të jemi në gjendje të qëndrojmë të durueshëm kur bota përreth nesh është e ndarë në shumë sosh? A mund t’i kuptojmë të tjerët kur nuk kuptojmë çfarë ndodh rreth nesh? Nëse pasojmë rrugën e babait të profetëve, Ibrahimit alejhis-salam, do shohim se gjatë gjithë kohës, Allahu na ka nën kujdesin e Tij dhe pavarësisht nga gjendja në të cilën gjendemi, në asnjë mënyrë nuk duhet ta humbim shpresën, pasi humbja e shpresës konsiderohet edhe humbje e besimit.

قَالَ وَمَنْ يَقْتَطُ مِنْ رَحْمَةِ رَبِّهِ إِلَّا الضَّالُّونَ ﴿٥١﴾

*Tha: "Askush nuk e humbë shpresën në mëshirën e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur."*⁹¹

Tashmë, pasi e kemi kuptuar domethënien e vuajtjes dhe llojet e saj, është mëse e mundur ta kapërcejmë atë duke u ngjitur përtej saj. Pyetja tjetër është: Si të bëhemi të lumtur? Ç'duhet bërë për të arritur gëzim dhe lumturi?

Përgjigja më e lehtë ndaj pyetjes së shtruar është domosdoshmëria e të bindurit dhe nënshtuarit dëshirës së Allahut. Nënshtimi nuk do të thotë të besojmë në fat e të themi: "të bëhet ç'të bëhet." Nënshtim apo bindje ndaj Allahut është kur të kryejmë punët dhe obligimet tona çdo ditë, kur të qëndrojmë në rrugën e drejtë të udhëzuar (nevoja për ta kënduar Suren el-Fatiha është shumë e qartë). Pasi kjo të ketë zënë vend në praktikën tonë, menjëherë do të jemi në gjendje që nga fjalori ynë ta asgjësojmë një folje. Ajo është: dua! Sa herë që përsërisim foljen 'dua', 'dëshiroj', vërejmë se nuk e kemi kuptuar foljen tjetër 'I nënshtrohemi, i bindem Atij që më ka krijuar'. Nëse i nënshtrohemi Allahut, do të shohim se Ai na dhuron vetëm atë që është e mirë për ne dhe do të na mbrojë nga të gjitha cytjet e Shejtanit, qofshin ato të dukshme apo të fshehta. Me të mbaruar së përmenduri foljen 'dua' apo 'dëshiroj' do të jemi të gëzuar, të lumtur dhe mirënjohës ndaj të mirave të Krijuesit.

Me arritjen e kësaj pozite të këndshme, bëhemi shumë të pasur, sepse ndihemi të lirë dhe të qetë; së

⁹¹ El-Hixhr (15), ajeti 56.

këndejsmi do të bëhemi zotërues në tokë së bashku me njerëzit përreth nesh. Allahu xh.sh. thotë:

الَّذِينَ ءَامَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ أُولَٰئِكَ لَهُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ

مُهْتَدُونَ ﴿٨٢﴾

“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me bestytini, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë.”⁹²

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ

فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ وَلَيُبَكِّنَنَّهُمْ

دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَىٰ لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُم مِّن بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا

يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَن كَفَرَ بَعْدَ ذَٰلِكَ

فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٨٥﴾

“Atyre nga mesi juaj që besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në tokë ashtu siç i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre; dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush mohon edhe pas kësaj, të tillët janë ata më të prishurit.”⁹³

Kur njeriu ka udhëzimin e vërtetë, me këtë arrin edhe një shkallë të sigurisë, e cila arrihet duke vepruar

⁹² El-En’am (6), ajeti 82.

⁹³ En-Nur (24), ajeti 55.

punë të mira. Allahu na ka premtuar se do të na dhurojë forcë dhe siguri, atëherë kur Atij nuk ia përshkruajmë asnjë shok. Po, mund të jemi të lumtur dhe nuk po flas për lumturi afatshkurtër, e cila zgjat një ditë apo më shumë. Unë jam duke folur për lumturinë, e cila bëhet pjesë e zemrës së njeriut. Çfarë ndodh më tej, kur lumturia bëhet pjesë e zemrës? Nëse dikush lëndohet, është shumë e lehtë për të që ta falë lënduesin. Një fuqi e brendshme e përshkon njeriun duke e bërë të qëndrojë gjithmonë kundër veprave të këqija; do të bëhet i mëshirshëm, i drejtë e në të njëjtën kohë edhe i devotshëm. Vetëm në këtë çast njeriu mund të kuptojë këto dy fjalë kuranore: ‘Allahu është Zoti ynë’. Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَفْتَمُوا تَنْزِيلَ عَلَيْهِمْ
 الْمَلَكِ أَلَّا تَخَافُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَبْشِرُوا بِالْجَنَّةِ الَّتِي كُنْتُمْ
 تُوعَدُونَ ﴿١٥٦﴾ نَحْنُ أَوْلِيَاؤُكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ
 وَلَكُمْ فِيهَا مَا نَشْتَهُى أَنفُسُكُمْ وَلَكُمْ فِيهَا مَا تَدَّعُونَ ﴿١٥٧﴾ نُزْلًا
 مِّنْ غَفُورٍ رَّحِيمٍ ﴿١٥٨﴾

“S’ka dyshim se ata që thanë: ‘Allahu është Zoti ynë’, dhe ishin të paluhatshëm në fjalën e tyre, atyre u vijën engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë): ‘mos u frikësoni, mos u pikëlloni, keni myzhde xhennetin që ju premtua. Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, kudo do të keni atë që dëshironi

dhe gjithçka kërkon. Pritje e nderuar prej Atij që fal mëkatet dhe është mëshirues’!”.⁹⁴

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَمُوا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ

مَحْزُونُونَ ﴿٤١﴾ أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا جَزَاءً بِمَا

كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٤٢﴾

“Ata që thanë: ‘Allahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikë, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen. Të tillët janë banues të xhennetit, aty do të jenë përgjithmonë, atë e kanë shpërblim për veprat që bënë.”⁹⁵

Po, këto fjalë të bukura mbajnë çelësin e dyerve të lumturisë, në fakt ato paraqesin falënderimin e njeriut ndaj ekzistencës së Zotit, Madhështisë, Bujarisë dhe Mëshirës së Tij, me çka njeriu ndihet i sigurt se Krijuesi, Allahu i Madhërishëm është i mirë.

⁹⁴ Fussilet (41), ajeti 30-32.

⁹⁵ El-Ahkaf (46), ajetet 13-14.

25. *Durimi (sabri)*

XXV. DURIMI (SABRI)

Durimi është një veçori e domosdoshme për njeriun, jo vetëm për një ditë, por ajo kërkohet në çdo orë të ditës. Kemi njerëz të cilët janë më të durueshëm sesa të tjerët, mirëpo nganjëherë të gjithë jemi të shtyrë deri në kufijtë tanë dhe kjo është koha kur problemi më i madh gjen hapësirë mes nesh. Në këto rrethana duhet të tregohemi shumë të fuqishëm, mirëpo këtu nuk kërkohet fuqi fizike, por fuqia e brendshme e njeriut: durimi. Lukmani i urtë, birin e tij e këshilloi me porosinë siç vijon:

وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ

الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٣﴾

*“Kur Llukmani, duke e këshilluar, birin e tij i tha:
‘O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, se idhuj-
taria është padrejtësia më e madhe’!”. ”⁹⁶*

Përparësia numër një është që Allahut kurrë dhe asnjëherë të mos i ngjisim shok, Allahu nuk i falë ata të cilët i shoqërojnë Atij të dytë, prandaj ky gjynah nuk falet. Më pas Lukmani i urtë vazhdon:

⁹⁶ Llukman (31), ajeti 13.

يَبْنِيْ اِيْنَهَا اِنْ تَكُ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِّنْ خَرْدَلٍ فَتَكُنْ فِيْ صَخْرَةٍ اَوْ فِي السَّمٰوٰتِ اَوْ فِي الْاَرْضِ يٰۤاَتِ بِهَا اللّٰهُ اِنَّ اللّٰهَ لَطِيْفٌ حَبِيْرٌ ﴿١٦﴾

“O djali im, s’ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, Allahu do ta sjellë atë, se Allahu është i butë dhe hollësisht i informuar.”⁹⁷

Nga ajeti kuranor mësojmë se duhet të vetëdijësohemi për veprat që bëjmë në këtë botë, pasi ato nuk mund t’i fshihen të Madhit Allah. Lukmani e këshillon të birin që të jetë i vetëdijshëm në të gjitha kohërat:

يَبْنِيْ اَقِمِ الصَّلٰوةَ وَاْمُرْ بِالْمَعْرُوْفِ وَاَنْهَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَاَصْبِرْ عَلٰى مَا اَصَابَكَ اِنَّ ذٰلِكَ مِّنْ عَزْمِ الْاُمُوْرِ ﴿١٧﴾

“O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara.”⁹⁸

Tani vëmendja i është kushtuar namazit, duke e urdhëruar për punë të mira dhe duke e ndaluar nga veprat e shëmtuara. Lukmani ka përmendur edhe durimin, duke na e bërë të ditur se me durim mund t’i bëjmë ballë çdo fatkeqësie, pavarësisht se çfarë është, ndaj duhet të qëndrojmë të fortë dhe të vendosur.

⁹⁷ po aty, ajeti 16.

⁹⁸ Llukman (31), ajeti 17.

وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلَا تَمْشِ فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ﴿١٨﴾ وَأَقْصِدْ فِي مَشْيِكَ وَأَعْضُضْ مِنْ صَوْتِكَ إِنَّ أَنْكَرَ الْأَصْوَاتِ لَصَوْتُ الْحَمِيرِ ﴿١٩﴾

“Dhe mos e shtrembëro fytyrën prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh që lavdërohet shumë. Të jesh i matur në ecjen tënde, ulë zërin, se zëri më i egër është ai i gomarit.”⁹⁹

Duhet ta kemi parasysh se në çastin kur mësojmë se si të bëhemi të durueshëm, do të mësojmë se të ecurit me kryelartësi është i ndaluar, mbi të gjitha, ne jemi të informuar nga ajeti i lartpërmendur se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë dhe ata që lavdërohen. Maturia gjithashtu është cekur në këtë varg kuranor, prandaj jemi të porositur siç u porosit i biri i Lukmanit që doemos të ulim zërin kur të flasim, pasi zëri i gomarit është më i larti e më i egri.

Fatkeqësisht, kemi një grup njerëzish, të cilët sapo arrijnë autoritet dhe pozita të larta, e shfaqin atë duke e ngritur zërin. Të paktë janë ata që veten e njohin si gomar. Të sjellim disa fjalë të mençura, pasi që urtësia nuk plaket. Të shohim se ç’ndodh në botën e amshueshme me ata që duruan? Allahu xh.sh. thotë:

فَوَقَلَهُمُ اللَّهُ شَرَّ ذَلِكَ الْيَوْمِ وَلَقَّاهُمْ نَضْرَةً وَسُرُورًا ﴿١٨﴾ وَجَزَّاهُمْ
بِمَا صَبَرُوا جَنَّةً وَحَرِيرًا ﴿١٩﴾

⁹⁹ po aty, ajetet 18-19.

“Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra dhe gëzim të madh. Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me xhennet dhe me petka mëndafshi.”¹⁰⁰

Duke bërë sabër, do të shohim se në Ditën e Llogarisë, do të jemi në pozitë të gëzimit dhe të haresë, meqenëse gëzimin nuk mund ta perceptojmë në esencën e tij, në Kuran na është përshkruar ngjashmëria e një kopshti ku në të, përveç gjërave të tjera, do të vishemi edhe me mëndafsh.

¹⁰⁰ El-Insan (76), ajetet 11-12.

26. Adekja

XXVI. VDEKJA

Është fjala për jetën tonë të përditshme. Çdo ditë që lëmë pas, na çon një hap më pranë vdekjes, ndaj edhe duhet të përgatitemi për këtë udhëtim. Në këtë situatë të veçantë, nuk ka nevojë për pasaportë, rroba të udhëtimit apo për plaçka personale, ndonëse konsiderohet prej udhëtimeve më të rëndësishme. Në këtë udhëtim nuk ka fare dyshim, dhe ai do të na shpierë te porta e botës së ardhshme. Ajo që duhet t'ia kemi frikën është se bota e ardhshme dallon nga kjo në të cilën jetojmë, pasi në botën e amshueshme s'ka më vdekje, ajo është e përjetshme, ndaj dhe duhet të përgatitemi sa më parë për një rrugëtim kaq të rëndësishëm. Ç'është vdekja? Allahu thotë në ajetin vijues:

اللَّهُ يَتَوَفَّى الْأَنْفُسَ حِينَ مَوْتِهَا وَالَّتِي لَمْ تَمُتْ فِي مَنَامِهَا
فِيْمَسَلِكُ الَّتِي قَضَىٰ عَلَيْهَا الْمَوْتَ وَيُرْسِلُ الْأُخْرَىٰ إِلَىٰ أَجَلٍ
مُّسَمًّى ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٤٧﴾

“Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre (trupave), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar vdekja e mban, kurse tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në

gjumë), e lëshon deri në afatin e caktuar. Vërtet, në këtë ka shenja për një popull që mendon.”¹⁰¹

Bazuar në ajetin kuranor dhe mësimet islame, vdekja është gjendje e shkurtër, kur shpirti braktis trupin për një kohë relativisht të shkurtër, dhe kjo i ngjason plotësisht gjumit. I vetmi dallim në mes gjumit të natës dhe gjumit të vdekjes qëndron në atë se gjumi i natës zgjatë tetë orë, ndërsa ai i vdekjes zgjatë disi më shumë. Nga kjo mund të themi se vdekja është një periudhë kalimtare ndërmjet dy formave të të ekzistuarit. Çdo njeri ka dy jetë; e para është jeta e kësaj bote, që ndryshe quhet edhe jeta kalimtare, ndërsa e dyta është jeta e amshueshme, të cilën e quajmë edhe jetë të përjetshme.

Ç’bart njeriu me vete ditën kur shpërngulet në botën e amshueshme, ditën kur vdekja i troket në derë e i sjell lajmin se tani i ka ardhur *exheli* dhe çdo gjë ka mbaruar? Ja se çfarë thotë Allahu i Madhërishëm lidhur me çfarë bart njeriu me vete për në botën e ahiretit:

وَيَوْمَ نُسَيِّرُ الْجِبَالَ وَتَرَى الْأَرْضَ بَارِزَةً وَحَشَرْنَاهُمْ فَلَمْ نُغَادِرْ
مِنْهُمْ أَحَدًا ﴿٤٧﴾ وَعَرَضُوا عَلَيَّ رَبِّكَ صَفًّا لَقَدْ جِئْتُمُونَا كَمَا
خَلَقْنَاكُمْ أَوَّلَ مَرَّةٍ ۚ بَلْ زَعَمْتُمْ أَلَّنْ نَجْعَلَ لَكُمْ مَوْعِدًا ﴿٤٨﴾ وَوَضِعَ
الْكِتَابُ فَتَرَى الْمُجْرِمِينَ مُشْفِقِينَ مِمَّا فِيهِ وَيَقُولُونَ يَا وَيْلَتَنَا

¹⁰¹ Ez-Zumer (39), ajeti 42.

مَالٍ هَذَا الْكِتَابِ لَا يُغَادِرُ صَغِيرَةً وَلَا كَبِيرَةً إِلَّا أَحْصَاهَا

وَوَجَدُوا مَا عَمِلُوا حَاضِرًا وَلَا يَظْلِمُ رَبُّكَ أَحَدًا ﴿١٩﴾

“Ditën kur Ne i shkullim kodrat, dhe tokën e sheh të sheshtë dhe Ne i grumbullojmë ata e nuk na mbetet asnjë prej tyre pa e tubuar. Dhe ata do të paraqiten para Zotit tënd të rreshtuar: ‘Na erdhët ashtu, siç ju krijuam herën e parë, por ju patët menduar se Ne nuk kemi caktuar për ju ringjallje.’ Dhe vendoset libri (i veprave), dhe i sheh mëkatarët të frikësuar nga shënimet që janë në të duke thënë: ‘Të mjerët ne, ç’është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (gjynah) të vogël e as të madh pa e përfshirë?’, dhe atë që vepruan e gjejnë të pranishme, e Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.”¹⁰²

يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ ﴿٢٠﴾ فَمَنْ يَعْمَلْ

مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ﴿٢١﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ﴿٢٢﴾

“Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre. E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”¹⁰³

I vetmi bagazh që njeriu do ta mbartë me vete ditën kur t’ia dorëzojë shpirtin Krijuesit janë veprat, të mira apo të këqija. Dita e llogarisë është dita në të cilën të gjithë njerëzimi do të dalë para Krijuesit për të dhënë llogari e padyshim se aty do të ketë fitim dhe humbje.

¹⁰² El-Kehf (18), ajetet 47-49.

¹⁰³ Ez-Zelzeleh (99), ajetet: 6-8.

Për ata që punuan dhe bënë vepra të mira, Allahu ka përgatitur kopshtet e Xhennetit dhe në të do të hyjnë të përgëzuar, ndërsa për ata që bënë vepra të këqija dhe Allahut i bënë rival, të tillët do të gjejnë atë që Allahu u ka premtuar e ai është Xhehenemi, vendi i krijuar nga zjarri dhe në të do të digjen. Lexues të dashur, Xhenneti dhe Xhehenemi janë të vërtetë. Ata janë të përherëshëm; nuk ka tallje e as kthim mbrapa. Të gjithë kemi një jetë për ta jetuar në tokë. Duhet të thellohemi mbi këtë dhe të kryejmë vetëm punë e vepra të mira. Tashmë kemi një alternativë për të zgjedhur, prandaj nga ne pritët që të zgjedhim rrugën e drejtë. Lexuesi do të kish-te pyetur se çfarë duhet vepruar për të qenë nga grupi i xhennetlinjve, që do ta gëzojnë parajsën?

Allahu xh.sh., në lidhje me këtë, thotë:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمتْ لِغَدٍ

وَأَتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾

“O ju që besuat, kijeni parasysh frikën ndaj Allahut dhe le të shikojë njeriu se ç’ka bërë për nesër; kijeni frikë Allahun, se s’ka dyshim se Allahu e di në detaje çfarë punoni!”¹⁰⁴

Të nderuar lexues, receta për të hyrë në Xhennet është shumë e thjeshtë; të lexojmë nga një ajet kuranor për çdo ditë, të falemi në kohë, të orvatemi që çdo ditë të bëjmë vepra e punë të mira. Allahu është shumë i drejtë e na do shumë, Ai nuk kërkon nga ne të pamundurën. Ajo që Allahu xh.sh. kërkon prej nesh është që

¹⁰⁴ El-Hashr (59), ajeti 18.

të bëhemi të mirë e të sjellshëm, e pasi të kemi ndryshuar dhe të jemi bërë njerëz të mirë, do të jemi ne ata që përfitojmë nga këto cilësi. E tillë është Madhëria e Allahut.

Lörfundimi

PËRFUNDIMI

Kurani është libri i fundit i shenjtë, i zbritur Muhamedit alejhisselam nga Allahu i Madhërishëm, përmes melekut (engjëllit) Xhibril alejhisselam. Mesazhi i Tij i zbritur 1418 vite më parë zotëron aftësi po aq të freskët zbatimi dhe realizueshmërie, i cili do të vazhdojë gjer në ditën e fundit, atë të shkatërrimit të kësaj gjithësie. Është mesazh i dashurisë, i udhëzimit dhe me të zbriti edhe drita. Allahu xh.sh. thotë:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ بُرْهَانٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ نُورًا

﴿١٧٤﴾ مُبِينًا

“O ju njerëz, juve ju erdhi nga Zoti juaj argument dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë.”¹⁰⁵

Drita dhe udhëzimi i Allahut shpalosen vetëm kur fjalët e Kuranit zbatohen në përditshmërinë tonë. Për këtë, Allahu xh.sh. thotë:

يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٧٤﴾

¹⁰⁵ En-Nisa (4), ajeti 174.

“Allahu e vë me atë (Kuranin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në rrugë të drejtë.”¹⁰⁶

Vetëm përfytyroni sikur të gjendeshit në një vend të errët, në një dhomë të panjohur e plotësisht pa dritë, dikush me kujdes lëviz nga e djathta apo nga e majta, tjetri nuk di se ç’të veprojnë, nuk di se çfarë e pret, kjo pastaj shpie në shqetësim dhe ankth, prej të cilit njeriu mund të rrëzohet e ta pësojë. Kështu e ka jeta, shumë shpesh nuk e dimë se ç’hap duhet të marrim dhe po që se ndjehemi të ngecur, mund të shkojmë edhe më tutje duke prishur jetën! Mirëpo, duke lexuar Kuranin, pajisemi me dritën që na mundëson shikimin e jetës së dhomës:

يٰٓأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَاٰمِنُوا بِرِسُوٰلِهِۦٓ يُوٓتِكُمْ كِفٰلَيْنِ مِّنْ

رَحْمٰتِهِۦٓ وَيَجْعَلَ لَكُمْ نُوْرًا تَمْشُوْنَ بِهٖ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ۗ وَاللّٰهُ

غَفُوْرٌ رَّحِيْمٌ ﴿٥٨﴾

“O ju që keni besuar, kijenit frikë Allahun dhe vazhdoni me besim ndaj të dërguarit të Tij, se Ai ju jep dyfish nga mëshira e Tij, ju dhuron dritë që të ecni me të, jua fal gjynahet; Allahu është mëkatfalës, mëshirues.”¹⁰⁷

Drita e cekur në ajetin e lartpërmendur është një dritë e cila sa më shumë që njeriu ta lexojë Kuranin, aq më tepër e gjen të forcuar. Është dritë që na siguron

¹⁰⁶ El-Maideh (5), ajeti 16.

¹⁰⁷ El-Hadid (57), ajeti:28.

mundësinë të shikojmë gabimet tona. Kur njeriu ta zotërojë këtë dritë dhe të jetë në gjendje t'i shohë gabimet, ajo e ndihmon t'i ndreqë ato dhe t'i zëvendësojë me vepra të mira. Më pas, në mënyrë graduale mësohemi që sa më pak të përfshihemi në gjynahe, pasi rruga që na pret është pastruar mjaft.

Jemi këtu që shpirtrat tanë ta ndiejnë Zotin sikurse ta kishin parë Atë dhe kjo do të ndodhë kur të dëshmojmë. Në momentin e dëshmisë, do të qarkullojmë rrugës së devotshmërisë që më pas vijon:

Devotshmëria të shpie në Lumturi

Lumturia të shpie në Kërkimfalje

Kërkimfalja në Dashuri

Dashuria në Dhënie

Dhënia në Pranim

Pranimi të shpie në Hare

Hareja në Vlerësim

Vlerësimi në Mirëkuptim

Mirëkuptimi të shpie te Krijuesi

Krijuesi, Një dhe i Vetmi.

PUNIMET DHE HULUMTIMET E
AUTORES

THE ROAD TO PEACE

★★★★

Research:

WHAT THE QUR'AN SAYS ON:

The Creation Of The Human Being

The Creation Of The Devil

The Creation Of The Heavens and The Earth

The End Of The World

The Prophet Ibrahim

Human Behaviour And Its Consequences

VOLUME I

Men and Women

This Scripture

Its Understanding

Prayers

Charity

Believers

VOLUME II

BIBLIOGRAFIA

1. Al-Quran, English translation of the meaning and commentary, by Abdullah Yusuf Ali, King Fahd Holy Quran Printing Complex, Mushaf Al-Madinah An-Nabawiyah, 1410 H.
2. Honey and Health, Laurie Croft, 1987 Thorsons P.G. Great Britain.
3. The Concise Oxford Dictionary, Sixth Edition, 1976
4. The New Encyclopedia Britannica, 15th Edition, 1983, U.S.A.
5. Shorter Encyclopedia of Islam, 4th impression, 1995, E. J. Brill.

RRETH AUTORES

Angala Milo (Hajjah Liza Abdullah) u lind më 18 Qershor 1951 në Angerola, (Napoli) të Italisë. Autorja ka shkruar librin “Rruga drejt paqes” si dhe punime tematike nga Kurani Fisnik, të cilat me vonë u botuan në dy vëllime, me titull: “Çfarë flet Kurani në lidhje me...?”

Ajo tani jeton në Shah Alam të Malajzisë me bashkëshortin e saj si dhe tre fëmijët.

PËRMBAJTJA

ABSTRACT	5
REZYME	6
PËRMBLEDHJE	7
FJALA E PËRKTHYESIT.....	8
PARATHËNIE	11
HYRJE.....	12
I. ZBATIMI I KURANIT JASHTË SHTËPISË.....	19
II. PËRSHËNDETJA	22
III. TË SHOQËRUARIT.....	25
IV. BESNIKËRIA DHE DREJTËSIA.....	28
V. MIQËSIA.....	32
VI. RREGULLAT MBI VESHJEN ISLAME	37
VII. MIRËSIA	42
VIII. ETIKA E NDËRVEPRIMEVE	47
IX. PASURIA	56
X. TË FOLURIT.....	61
XI. FUQIA E FJALËVE	67
XII. PREMTIMET.....	72
XIII. GËNJESHTRA.....	76
XIV. DJALLI	79
XV. BIXHOZI DHE PIJET ALKOOLIKE.....	86
XVI. HIGJIENA VETJAKE	91
XVII. RREGULLAT USHQIMORE	94
XVIII. NAMAZI.....	99
XIX. LËMOSHA (SADAKAJA).....	105
XX. SHËNDETI	110

<i>XXI. FAMILJA</i>	116
<i>XXII. PËRGJEGJËSIA INDIVIDUALE</i>	126
<i>XXIII. FRIKA</i>	131
<i>XXIV. VUAJTJA DHE LUMTURIA</i>	135
<i>XXV. DURIMI (SABRI)</i>	145
<i>XXVI. VDEKJA</i>	150
<i>PËRFUNDIMI</i>	156
<i>PUNIMET DHE HULUMTIMET E AUTORES</i>	159
<i>BIBLIOGRAFIA</i>	160
<i>RRETH AUTORES</i>	161
<i>PËRMBAJTJA</i>	162